



ÇFARË PO NDODHË
NË SHKODËR ME ÇËSHTJEN
E VAKËFIT NË ZDRALEJ?



TË KRIJOJMË
NJË LIDHJE TË RE
ME ALLAHUN E MADHËRUAR



KUJDESI!...
PO SHKOJMË DREJT NJË
ASIMILIMI TË FRIKSHËM..!

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 23 - Nr. 7 (269), Korrik, 2025

www.myftinia-shkoder.org



MYFTINIASHKODER1990

GJENOCIDI NË GAZA, RËNIA E MITIT TË BOTËS SË LIRË!



MYFTIU ZHVILLOI NJË TAKIM PUNE
ME KRYETARIN E BASHKISË SHKODËR

MYFTIU PRITI IMAMË TË NDERUAR
SHQIPTARË NË ZVICËR

GJITHÇKA QË DINIM RRETH
VRASJES, DHUNËS DHE PASTRIMIT
ETNIK ËSHTË ZHVLERËSUAR TASHMË!

MYFTINIA SHKODËR, KONTRIBUT
FAMILJES REXHEPI NË GOLEM
PAS DJEGIES SË SHTËPISË

“ZEMËRIMI I ZDRALES – NOSTALGJIA
E UZURPIMIT DHE POLITIKA
E PRONËS SË TJETRIT”

PSE NUK DUHET TË HESHTIM
PËR LUFTËN E SHKODRËS
1912-1913?

ÇFARË PO NDODHË NË SHKODËR ME ÇËSHTJEN E VAKËFIT NË ZDRALEJ?

Myftiu Sytari sqaron besimtarët me fakte e dëshmi!

Nga hytbeja e xhumasë në xhaminë e Parrucës, më 11 korrik 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka sqaruar para besimtarëve dhe mediave procesin lidhur me tregun e Zdrales që ndodhet në tokën vakëf të Myftinisë Shkodër.

Myftiu ka thënë se që në vitin 2013, trualli ku është vendosur tregu, ka kaluar në pronësi të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Sapo kjo ka ndodhur, tregtarët janë thirrur dhe njoftuar për ta liruar duke u dhënë si afat ekstem për lirimin e tij data 1 janar 2015!.

“I kemi njoftuar të gjithë tregtarët dhe i kam pritur në zyrë që në momentin e këtij lajmërimi, që nga viti 2013. Nuk po flas përpara, as për çfarë Bashkia e Shkodrës ka bërë tek stadiumi: për tregun që ajo ka ngritur, jo ne. E ka ngritur mbi tokën e dikujt, e vetëdijshme se nuk është pronë e Bashkisë.

Në tetor të vitit 2013, Myftinisë së Shkodrës i është bërë kthimi i pronës vakëf në Zdrall, 3782 m², por prona jonë është shumë më e madhe sesa këto metra, e mbajtur në përdorim nga ana e Bashkisë Shkodër gjatë gjithë këtyre viteve. Nuk kemi përfituar as nga Bashkia, as nga ata, as edhe një qindarkë! Se njeriu ka fytyrë, ka ndërgjegje!

Dikush është dashtë të thotë: ‘Po, unë jam këtu, por kjo nuk është prona ime! Nuk ma ka lënë as baba, as gjyshi. E kujt është kjo pronë? E Myftinisë! Më e pakta të shkoj te Myftinia e t'i them: – Zotëri, unë e di se ju sot nuk e keni kthyer këtë pronë, por me hak të Zotit ajo është pronë e juaja. Unë me zemër

do ta sjellë 100 lekë në muaj. Kaq e kam mundësinë!’

Kjo nuk ka ndodhur nga askush! Me kthimin e pronës, Myftinia Shkodër ka kërkuar zhvillimin e atij vakëfi. Kjo është kontrata e parë që është nënshkruar asokohe në vitin 2014. Tregtarëve, ky që flet, u ka thënë: ‘Do të rrini aty ku jeni. Nuk ju nxjerr kush as për sezonin veror, as për fillimin e sezonit shkollor, as për Krishtlindje e as për Vitin e Ri, se njerëzit blejnë. Në janarin e vitit tjetër të bëheni gati dhe të dilni!’

Myftiu Sytari, gjatë hytbes së tij, ka reaguuar edhe ndaj disa mediave dhe portaleve, të cilat me papërgjegjshmëri, madje edhe me dashakeqësi, bëhen palë me të pavërtetat, lidhur me një çështje që është tepër e qartë dhe transparente.

Na akuzoni ne se kështu e ashtu? Jo! Këto merrini mbrapsht ju dhe mediat tuaja dhe kushdo! Unë e di. Është shumë e dhimbshme që ti të punosh në një vend, ku nuk është prona jote, nuk është vendi yt dhe në një moment i zoti i tokës të vijë dhe të thotë: – Zotëri të lutem liro tokën!

– Jo, unë se liroj!?

Ky është mentaliteti i shpellave. Ky është mallkim i madh për pronarin e vërtetë, që nga ligji famëkeq 7501 dhe nga shokët e Iblisit që punojnë me kazmat e shkatërrimit të pronës për herë të dytë mbi kurrizin e pronarëve legjitim. I pari pronar legjitim dhe më i madhi i atyre që është prekur në Republikën e Shqipërisë nga ky ligj famëkeq, është Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe të gjitha Myftinitë!”, ka deklaruar më tej Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.



IMAM VEHBİ ISMAILI
(1919 - 2008)

“**L**ibrin ynë i Shenjtë, **KUR'ANI VËRTETON PROFETËSINË E TËRË PROFETËVE TË NJOHUR, SI: IBRAHIMI, MUSAI, ISAI DHE TË TJERË. TË QJITHË PROFETËT I PËRMEND ME LAVDËRIM DUKE TREQUAR MORALET E TYRE TË LARTA DHE SHËRBIMET, QË I KANË SJELL NJERËZIMIT.**

NË ANËN TJETËR, NË KUR'AN LEXOJMË: “Nuk ka imponim në fe!” – Prandaj, nuk duhet të habitemi, që Muhammedi (a.s) u siguroi besnikëve të çdo feje lirinë e besimit. Sidomos kur ai vetë e provoi sa e vështirë është të jetosh në një rreth, që nuk të lejon të besosh dhe të mendosh si të duash.

(Nga libri: Muhammedi Profeti Islam)



H. Sadush ef. Tahiri
Ligjërues islam, Shkup

Ai që nuk ka hy në xhenetin e dynjasë, nuk mund të hyjë në xhenetin e ahiretit. Për të hyrë në xhenetin e tillë duhet doemos njohja e Allahut, Krijuesit dhe Drejtuesit të gjithësisë, sepse Ai është që drejton dynjanë në imtësi.

Pse kjo jetë plot çrregullime, probleme, vuajtje, shqetësime? A është koha e ripërtëritjes së lidhjeve me Allahun? Të dimë se kjo gjithësi e ka një Zot që kujdeset për të!

Dhikri dhe ndikimi i tij në shpirt, jetë dhe trup! Si ta ndiejmë Allahun në jetën tonë?

Mendon për këtë: Dhikri është “arma e fshehtë” e besimtarit, që kur gjërat vështirësohen dhe bëhen të pamundura, ai përdor armën e tij të fshehtë (dhikrin). Mos harroni se besimi është ai që gjërat i kthen si të dojë dhe për një çast, besimi i rirregullon kriteret dhe baraspeshat e jetës i shndërron papritmas në gjallëri! Magjistarët e faraonit për pesë sekonda vetëm ranë në sexhde! Askush nuk e di këtë armë të fshehtë, përveç besimtarit!

“E kemi krijuar njeriun në përpjekje!” – thotë Allahu i Madhëruar. Prandaj, mos mendo se në jetë nuk do të gesh vështirësi dhe probleme, mos mendo se nuk do të ndeshesh me probleme, probleme materiale, shëndetësore, familjare, etj.

- Vetë të dërguarit të Allahut ishin që në jetë përjetuan shumëçka: në këtë rrugë u lodh Ademi (a.s), u lodh Nuhu (a.s), u bë kurban Ismaili (a.s), u hodh në zjarr Ibrahim (a.s), përjetoi shumë Ejubi (a.s), u përzu Jusufi (a.s), u mundua shumë Isai (a.s), përjetoi shumë Merjemja (a.s), dhe Resulullahu (a.s) përjetoi shumë e shumë.

- Edhe ti mos harro se qysh në mëngjes ballafaqohesh në luftën me djallin e pandalur, do të gesh një hipokrit që të del përpara, një jobesimtar që nuk di

TË KRIJOJMË NJË LIDHJE TË RE ME ALLAHUN E MADHËRUAR

sexhde, por besimtari e di se gjithmonë ka ndihmës dhe mbështetës, ai është DHIKRI.

- “O ju besimtarë, kur të ndesheni me një gurrp (jobesimtarë), qëndroni të palëkundur dhe përmendeni Allahun shumë..” – Cila është fshehtësia e përmendjes së Allahut në përlëshje dhe gjatë saj? Po sot që ndeshemi dhe ballafaqohemi me probleme jetësore?!

- A është pra e vërtetë se dhikri na jep forcë shpirtërore dhe është armë e jashtëzakonshme në ballafaqimin me problemet e jetës? Po!

- Në probleme materiale përmende Allahun, probleme bashkëshortore përmende Allahun, shpejto dhe fali dy rekatë namaz menjëherë, probleme në punë, lexo Kur'an, siç thamë fali dy rekatë menjëherë, do të vësh se këto dy rekatë të japin forcë të paparë, se kështu bënte Resulullahu (a.s), na duhet kjo fuqi sot, e që shumë nga ne janë të pavëmendshëm, prandaj edhe na shtohen vuajtjet, humbim qetësinë shpirtërore.

Mundohu ta shohësh dorën e Allahut që vepron fshehurazi dhe që i lëvizë gjërat, por fshehurazi, kënaqu me kaderin e Allahut, zgjohu me lumturi, sepse çdoherë që mbetesh i kënaqur jeta bëhet e bukur. Hasedi (smira) të shkatërron fizikisht dhe shpirtërisht. Largohu nga hasedi (smira). Vëllezërit e Jusufit nuk e duruan Jusufin dhe e larguan, por gjithmonë mbetën të nënçmuar, plot 40 vjet nuk e shikuan babanë e tyre në sy edhe pse hanin dhe flinin nën një kulm!

- Jetojmë në kohën që vuajtjet dhe problemet veç se vijnë dhe bëhen më të mëdha, nga çdo anë vijnë, papritmas bile, kriza të natyrës së ndryshme, kriza bashkëshortore, familjare, në punë, me fqinj e shokë...prandaj na duhet lidhje e fortë me Allahun e Madhëruar.

- Ndoshta thua: Si do të më ndihmojë dhikri?

- Mos harro se dhikri e largon djallin, i cili i ndez të gjitha krizat dhe problemet në jetë, ai e ndez pakënaqësinë me kaderin e Allahut, zjarr në zemër ndez, e kur ti përmend Allahun, ai humbet dhe shkrihet; vesveset pakohen, shpirti qetësohet, dhe mos harro se dhikri krijon dritë në zemër dhe besimtari fillon

të sheh me dritën e Allahut, të lëvizë me dritë, gjërat lëvizin habitshëm, e sheh se dora e Allahut po vepron fshehurazi, dhikri t'i hap dyert e jetës dhe të jep rrugëdalje nga krizat, t'i tregon pasojat e veprave, fundin e tyre të vërtetë, dhe habitesh dhe habitesh dhe habitesh se si u bënë këto punë: si u zgjidhën problemet? Si e solla vendimin e saktë: kush më frymëzoi? Sepse, Allahu t'i tregon rrugët e jetës, vëren se Allahu kurrë nuk të ka lënë anash, të ka frymëzuar vendimin, habitesh se prej nga erdhi suksesi dhe mbështetja, si u bë që morra hapin e duhur në moment të caktuar?!

Ai që e harron Allahun mbetet gjithmonë në hutë, edhe pse mund të jetë shumë i mençur! Vallahi, dije se asgjë nuk mund të bësh pa ndihmën e Tij!

- Ti ke nevojë për frymëzimin e Allahut në çdo hap të jetës, e në luftë për jetë?! Ti mendon se hapi i tjetrit apo vendimi i tjetrit ta ka me të ndihmuar, ka me ta zgjidh problemin, po në të vërtetë, ai veç se ta ka rrit problemin! Kjo, sepse ti je bërë mahrum (je privuar) nga suksesi i Allahut dhe mbështetja e Tij, e kur Allahu të mbështet, dije se Ai të mëson çka të thuash, kur ta marrësh vendimin, kur ta hedhësh hapin... kur Allahu të do, të zgjedhë të falesh në saf të parë!!

- Dije se Allahu ka me krijuar sebepe, vetëm nëse je besnik në drejtim, do t'i hap dyert, do t'i paguash borxhet. Tek Allahu nuk ka PSE dhe SI?!

- Salevatet për Resulullahun, a e dini çka bëjnë!! Shkronjat e salevatit janë mrekulli, vetëm kujdes shqiptimin e tyre, shkronjë për shkronjë, sikur e përpinë ëmbëlsinë e salevatit. Të gjithë pohojnë se salevatet për Resulullahun janë shkak i zgjidhjes së qindra problemeve! Tha Resulullahu: e pra brenga do të hiqet, gjynahu do të falet, problemi do të zgjidhet!

- Vetëm pse e lëviz gjuhën me dhikër, shpërblehesh, paramendo! Shpërblehesh, lëvizje e gjuhës! Ne kemi nevojë istigfarin, çdo ditë, çdo çast, në çdo hap, istigfar pune, jo dembelie!

- Sahabiut, shigjeta në qafë, i del gjak – pse? Po s'deshta me të shqetësuar, nuk isha gafil!

- Ti sheh atë që të tjerët nuk e shohin!



“PËRJETIME HAXHI” MBRESA TË PAHARRUARA NGA UDHËTIMI NË VENDET E SHENJTA (Përshtypje nga aktiviteti i datës 28.6.2025)

**H. YLBER RUPA, MURSHID
I HAXHIT TË SIVJETSHËM, 2025**

Selam alejkum!



Si fillim më lejoni të falënderoj institucionin e Myftinisë Shkodër, për organizimin e aktivitetit të përvitshëm, “Përjetime Haxhi”.

Dua të theksoj, se Haxhi i këtij viti ishte një përvojë e madhe për mua, për vetë faktin, së këtë vit isha zgjedhur nga KMSH si murshidi juaj, pra i haxhilerëve të Shkodrës.

Me këtë rast më lejoni që të shpreh mirënjohjen time edhe ndaj jush, haxhilerëve të Shkodrës, për mirëkuptimin tuaj gjatë gjithë ritualit të Haxhit të cilin e realizuam së bashku.

Me të vërtetë kaluam momente të papërsëritshme, sidomos gjatë qëndrimit në Mina, Muzdelifeh dhe Arafat, po ashtu dhe kryerjen e tavafit të Haxhit.

Me të vërtetë ishin momente të paharruara për ne, që do të na ngelen në mendje për një kohe të gjatë.

Dua të përmend gjithashtu dhe bashkëpunimin me murshidin tjetër të haxhilerëve të Shkodrës, H. Altin Nikshiqi dhe gjithashtu me murshidët e grupeve të tjera.

Me kthimin nga Haxhi, na është dhënë nga KMSH një sondazh për përshtypjet e Haxhit të sivjetshëm, në mënyrë që të shohim pikat e dobëta dhe çfarë mund të përmirësojmë akoma, në mënyrë që t'i shërbejmë haxhilerëve shqiptarë në vitet në vijim në mënyrën më të mirë të mundshme.

Me këtë rast i ftoj gjithë vëllezërit dhe motrat haxhilerë t'i përgjigjen këtij sondazhi me përshtypjet e tyre.

Para se të përfundoj fjalën time, si murshidi juaj, ju drejtohem duke ju kërkuar hallallëk nëse keni pasur ndonjë

shqetësim nga ana ime, sepse në fakt të jem murshidi juaj këtë vit ishte një përvojë e veçantë për mua, ngaqë ishte hera e parë që marr përgjegjësinë e murshidit për grupin e haxhilerëve të Shkodrës.

Edhe pse un e kam kryer Haxhin tim para shumë vitesh, kjo ishte një përvojë e veçantë, ngaqë pash se gjërat kishin ndryshuar shumë ndër vite, në krahasim me ato që kujtoj unë para shumë vitesh.

Dhe kjo me të vërtetë ishte një përvojë e mirë për mua dhe lus Allahun (xh.sh), që kjo herë mos të jetë hera e fundit që shkojmë në Haxh, Allahu na e pastë pranuar Haxhin tonë!

Një falënderim i veçantë shkon gjithashtu për Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed Sytarin, i cili është nismëtar i këtij aktiviteti të përvitshëm për haxhilerët e Shkodrës, që në realitet asnjë nga Myftinitë e rretheve nuk organizon një aktivitet të tillë, bile do të shtoja gjithashtu dhe ceremoninë e përcjelljes dhe pritjes së haxhilerëve, e cila me të vërtetë është diçka që lën mbresa tek hanxhinjtë.

Ju faleminderit, dhe selam alejkum!

HAXHILERJA EMINE ALUSHI

Selam alejkum!



Megjithëse kjo është hera e tretë që unë shkoj në Haxh dhe më duket sikur sa herë që shkojmë atje na shtohet më tepër dashuria dhe dëshira për të vizituar ato vende të shenjta!

Sinqerisht, të them të drejtën këtë Haxh e kam përjetuar shumë herë më mirë sesa herët e shkuara, ndoshta edhe për vetë faktin se edhe grupi jonë ishte më ndryshe nga grupet e kaluara.

Dhe ia vlen të përmend, se ishte një grup tepër i organizuar, sidomos në shkuarjet dhe ardhjet në Qaben e Madhërueshme, ashtu sikurse gjatë tavafit kur kryem Umrën e dytë shtesë, ose qëndrimit në Rauda Sherife; kjo e fundit në fakt ishte një kënaqësi në vete dhe emocionet pa dyshim që ishin të pakrahasueshme.

Sidomos, në momentin kur ne po aplikojmë për lejen nëpërmjet aplikacionit të vizitës së Raudes Sherife, (NUSUK); ku në fakt s'do ta harroj lehtë për shkak të emocioneve që na dha gjatë aplikimit, ku disa prej motrave arritën ta merrnin lejen shumë shpejt e ndërsa për disa të tjera i zgjati marrja e lejes gati dy ditë.

Në fakt, shumë prej motrave tona nuk e dinin kënaqësinë dhe emocionet që të sjell qëndrimi në Raudah, por mbasi dolën nga atje, secila prej tyre kishte dëshirë që të qëndronte shumë më tepër.

Gjithashtu dua të përmend dhe emocionet e qëndrimit në Arafat të cilat nuk harrohen kollaj, ku një grup prej 20 vetash nga motrat tona, që çadra në të cilën ishim caktuar nuk kishte vend për të gjitha dhe i caktuan në një çadër më vete.

Ajo që kujtoj sinqerisht që e gjitha koha që kishim në dispozicion ditën e Arafatit, e kaluam në adhurim, dhe Elhamdulillah, jemi munduar që të kalojmë minutat më të mira gjatë qëndrimit në Arafat në adhurim, dhe çdo gjë shkoi për së mbari me mirësinë e Allahut (xh.sh).

Falë mirësisë së Allahut, secila nga ne gjatë kohës së Haxhit, ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe askush nuk ankoj apo pati vështirësi.

I lutem Allahut (xh.sh) që të na mundësojë një Haxh tjetër të gjithave së bashku siç ishim! Dhe, sapo i pashë të gjitha motrat sot këtu, ajo që më erdhi në mendje ishte: A jena të gjitha për të shkuar edhe një herë në Haxh kështu siç jemi?!

Allahu ju shpërbleftë me të mira edhe juve për çdo shërbim dhe kujdesje e respekt nga ana juaj, si në momentet e përcjelljes ashtu si edhe ato të pritjes.

**H. ADEM PIZGA
IMAM I XHAMISË PERASH**

Selam alejkum!



Falënderimet i takojnë Allahut (xh.sh)!

Me fol për përjetimet e Haxhit, për përjetimet e atij udhëtimit të mrekullueshëm, fjalori im nuk gjen fjalët e mjaftueshme për përshkrimin e duhur kursesë dhe për këtë jemi të vetëdijshëm.

Ama gjithsesi do të mundohem t'i them disa fjalë, sepse me të vërtetë, shkuarja në ato vende të shenjta është një mirësi e madhe, është një privilegj shumë i madh, që Allahu (xh.sh) ua jep atyre njerëzve, të cilët shkojnë në atë vend.

E para, do të thoja, ata njerëz të cilët shkojnë në vendet e shenjta duhet të jenë të vetëdijshëm, se janë mysafirët e Allahut (xh.sh), janë të ftuarit e Allahut (xh.sh).

Sot, në hutben e xhumasë e përmenda duke thënë, se në Haxh nuk shkohet me lekë, në Haxh shkohet me thirrje, shkon nëse të thërret Allahu (xh.sh) dhe jo nëse ke lekë!

Sepse, në realitet ka njerëz të cilët kanë shumë lekë dhe nuk shkojnë në Haxh, si dhe ka njerëz të cilët nuk kane lekë dhe në fakt kanë shkuar me shumë se një herë.

Prandaj, ajo shkuarja atje është një zgjedhje hyjnore, që d.m.th me të zgjedh Allahu (xh.sh) dhe të thërret, e ndërsa ti thjesht i përgjigjesh thirrjes së Tij!

Dhe, mendoj se haxhilerët dhe umrexhinjtë që shkojnë atje duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë, pra me pak fjalë, je një i ftuar i Allahut (xh.sh).

Po shkel në tokën më të mirë, në tokën më të dashur të Allahut (xh.sh), në Mekën e Madhërueshme.

Me ikë me u falë përpara kibles së gjithë myslimanëve të botës, përpara Qabes së Madhërueshme, para asaj xhamie të mrekullueshme, ku ndjen një tërheqje, një thirrje të jashtëzakonshme!

Ju e keni vënë re, kur ishit atje, nëse e falë namazin diku në xhaminë e Qabes së

Madhërueshme, pa e pare Qaben, sikur ke një mangësi, nuk ndihesh i plotësuar krejtësisht.

Syri ta kërkon Qaben e Madhërueshme, dëshiron ta shohësh dhe në momentin që ti e sheh atë, atëherë ndihesh i plotësuar.

Kështu që, me disa prej vëllezërve, kur shkonim në Qabe për të falë vaktet, kryesisht namazin e akshamit apo të jacisë, ishim pa veshjen e ihramit dhe s'na lejonin që të hynim në brendësi të Qabes për t'u falur përballë Qabes.

Atëherë gjenim një derë të madhe, prej të cilës nga oborri direkt arrijmë të shihnim Qaben e Madhërueshme. Ndërsa faleshim, njëkohësisht shihnim dhe Qaben, ishte një mirësi e madhe!

Ia vlen të përmend, që një përjetim tjetër nga vendet e shenjta ishte, se kur njeriu shkon atje, reflekton dhe i vjen në mend që ndodhet në vendlindjen e Pejgamberit tonë të dashur, Muhammedit (a.s)!

Është duke ecur në token ku Pejgamberi (a.s) është rritur dhe është bërë burrë, ku ka kaluar pjesën më të madhe të jetës së tij; pothuajse 53 vite nga jeta e tij i ka kaluar në Meken e Madhërueshme.

Dhe, kur i mendon këto, është me të vërtetë një emocion në vetvete, kur ecë në rrugët e Mekes e mendon dhe ndjen këtë emocion krejt të veçantë.

Ose, thjesht kur e mendon se po në atë vend është zbritur shpallja në shpellën e Hirasë. Kur njëri nga haxhilerët tanë të rinj me kërkoi që ta shoqëroj për në shpellën e Hirasë, i thashë: Është shume larg, dhe me të vërtetë është shume larg dhe ka shumë lodhje mbërritja në atë shpellë, por qe nuk ia prisha edhe pse u lodhëm, një orë me mbërrit dhe një orë me u kthye.

Dhe, Subhanallah! Aty ishte një mësim në vetvete dhe po i thosha atij të riut: A e sjell dot në mend Pejgamberin tonë (a.s), i cili ka ardhur këtu, në këtë shpellë, i vetëm duke medituar për Zotin e vet, dhe jo vetëm këtë, por medito gjithashtu bashkëshorten e tij, Hatixhen e cila në një moshe jo të re, shkonte çdo ditë nga shtëpia e saj që ndodhej afër Qabes, në këmbë deri te shpella e Hirasë, ku është ngjitur dhe është ulur dhe ku kthehej përsëri. Pra, mendoje pak sakrificën e saj, dashurinë për bashkëshortin.

Të gjitha këto janë refleksime, të cilat të sjellin emocion dhe një ndjesi të veçantë, elhamdulillah!

Pastaj, qëndron dhe aspekti i sevapit! Aspekti i shpërblimit të madh, ku ne,

sa herë qe shkonim në Qabe për të falur namaz, i thoshim njëri-tjetrit: I morëm inshallah edhe 100 mijë sevape, elhamdulillah!

Dhe, pas çdo namazi farz kishte një namaz xhenazeje dhe për këtë, i thoshim njëri-tjetrit: E morëm edhe një kodër Uhudit me sevape inshallah. Krejt këto momente, i krijojnë këto emocione të veçanta.

Dua të përmend pak edhe udhëtimin nga Meka në Medine. Dhe, kur shikon gjithë atë rrugë, gjithë ato kilometra, i nxehti, lodhja, edhe pse ne i kishim të gjitha kushtet e mira, transporti me kondicioner, dhe kur mendonim Pejgamberin (a.s), se si ka udhëtuar gjithë atë rrugë, me ditë të tëra mbi deve, në atë të nxehtë, dhe gjithë ajo sakrificë, subhanallah!

Dhe, pastaj pjesa më e ëmbël është mbërritja në Medine, e cila është e jashtëzakonshme!

Të përballesh me xhaminë e Pejgamberit (a.s) është një ndjesi e jashtëzakonshme! Gjithashtu, momenti për t'i dhënë selam Pejgamberit (a.s) dhe dy shokëve të tij të nderuar, Ebu Bekrit dhe Omerit, dhe falja e namazit në Raudah Sherife, krejt këta janë përjetime të paharrueshme, të cilat siç e përmenda edhe më parë, se fjalët e mia nuk janë mjaftueshme për t'i përshkruar siç duhet këto emocione.

Unë besoj se ata që na kuptojnë më së miri, kur flasim për këto emocione dhe ndjesi, janë ata, të cilët kanë pasur mundësinë të shkojnë atje në ato vende të shenjta.

Dhe, në fund dua të them, që edhe pse kam disa herë, që kam shkuar në vendet e shenjta, do ta theksoj se kjo hera e fundit ishte pas një shkëputjeje shtatë vjeçare; të them të drejtën isha i tharë nga malli sikurse ajo toka e shkretët, e cila çahet nga mungesa e shiut dhe ujit, aq shumë isha i përmalluar për ato vende!

I jam lutur Allahut (xh.sh): O Zot, ma mundëso që të vij shpesh në këtë vend në mënyrë, që të mos thahem kaq shume nga malli!

E lus Allahun që të na e mundësojë që të shkojmë përsëri sa më shumë, dhe të na e ketë pranuar Haxhin dhe lutjet tona, dhe të na e ketë mundësuar të jemi kthyer të gjithë të falur nga gjynahet sikurse na ka lajmëruar dhe Pejgamberi jonë (a.s). Ju faleminderit!

H. ERVIS MOLLA IMAM I XHAMISË BARBULLUSH

Selam Alejkum!



Emocion shumë i madh me patjetër, bile duke prezantuar sot këtu në këtë mexhlis, po me kujtohen akoma mexhliset që organizoheshin atje nga murshidët tanë, ku na tregonin disa parime dhe rregulla bazë që duhet t'i ndiqnim gjatë kohës që ishim atje.

Kjo tregon, se ajo shija e atjeshme e këtyre mexhliseve, akoma vazhdon.

Si fillim, dua t'i lutem Allahut (xh.sh), që të na e ketë pranuar Haxhin dhe të jemi kthyer nga atje me gjynahe të falura!

Patjetër, që emocionet ishin shumë të mëdha, duke filluar që nga nisja, ose qysh nga nijeti i Haxhit. Pikërisht aty fillon emocionin, aty fillon e rreh zemra, për vetë faktin, se ti po i mësynë adhurimit të Allahut (xh.sh).

Po i drejtohesh Krijuesit tënd, i Cili na ka krijuar shpirtin dhe i Cili na do dhe ka zgjedh secilin prej nesh për të shkuar atje.

Ky ishte Haxhi im i parë dhe besoj se kjo thirrje nuk vjen kur do njeriu, por kur ta mundëson Allahu (xh.sh).

Në lidhje me këtë, me kujtohet një miku im, Blendi, që ishte në Haxh me mua këtë vit, i cili më thoshte para se të niseshim: Nëse do Allahu (xh.sh) me të pasë në shtëpinë e Tij, do të vijmë ne të gjejmë dhe të marrim kudo që të jesh, për të të sjellë në Haxh!

Po ashtu, edhe me Myftiun e nderuar, me të cilin jam takuar para se të niseshim, ku kemi biseduar para Haxhit, dhe fale mirësisë se Allahut, na u dha mundësia që të shkonim në Haxh.

Jam dëshmitar i disa rasteve që më kanë bërë përshtypje në Haxhin e sivjetshëm, për forcën dhe përkushtimin e disa haxhilerëve, të cilët edhe pse ishin në moshë të madhe dhe fizikisht ishin të dobët, nuk tërhiqeshin nga rituali i tavafit, as nga i nxehti, e as nga lodhja, por vazhdonin adhurimin me përkushtim të madh edhe pse në moshë të thyer.

Në një rast tjetër, teksa po ecja nëpër rrethinat e Qabes, vura re një oficer të

lartë, i cili po i jepte udhëzimet ushtarëve dhe policëve, të cilët u shërbenin haxhilerëve; e dëgjova duke i thënë: O djem, keni kujdes me haxhilerët, sepse ata janë miqtë e Allahut dhe lutjet e tyre janë të pranuar në këtë vend të shenjtë! Kini kujdes dhe silluni butë me ta dhe mos ja thyeni zemrën e tyre!

Dhe, në lidhje me këtë, mbasi u ktheva nga Haxhi, po lexoja një ditë një sondazh mbi Haxhin e këtij viti dhe sipas statistikave, thuhej që shënohej të ketë qenë Haxhi më i suksesshëm në 30 vitet e fundit, dhe kjo është një mirësi e madhe. Faktikisht, jam dëshmitar i këtij fakti, sepse organizimi i Haxhit në këtë vit ishte pothuajse perfekt.

Po ashtu, qëndrimi im në Arafat, elhamdulilah, që Allahu ma mundësoi të kryej dhe hatmen e Kur'anit po atë ditë, dhe mezi prisja të qëndroja në Malin e Mëshirës për të bërë lutjet e mia, sikurse çdo haxhi, i cili kishte ardhur nga anembanë botës, me shpresën në fjalën e Allahut (xh.sh): “Lutmëni Mua, Unë do t'ju përgjigjem!” Me të vërtetë një emocion i paharrueshëm!

Elhamdulilah, ma mundësoi Allahu (xh.sh), që në këtë Haxh të kryej disa Umre, me mendimin se kushedi se kur ma bën Allahu rizk, që të kthehem përsëri.

Ajo që dua të theksoj, gjithashtu është se edhe pse s'ka shumë që sapo jam kthyer nga vendet e shenjta, pasha Allahun, më ka marr malli për ato vende, bile çdo ditë që zgjohem në mëngjes, e falënderoj Allahun (xh.sh) që ma mundësoi të kryej Haxhin, dhe i lutem që të ma mundësojë serish inshallah!

H. ASLLAN BABA IMAM I XHAMISË MJEDË

Selam alejkum!



Të them të drejtën, haxhilerët para folës i përmenden krejt pothuajse përjetimet tona, sepse pak a shumë janë të ngjashme, por do të kthehem pak në kohë, në vitin 2013, kur unë krevaja Haxhin tim të parë të Islamit.

Në atë kohë, mu duk e lodhshme komplet Haxhi, me ecjen në Safa dhe

Merva, dhe tavafet e vazhdueshme, sa që kishte raste kur shtrihesha në Qabe nga lodhja.

Prandaj, kam një këshillë për të gjithë besimtarët, që duan të shkojnë në Haxh, ju lutem kryeni Haxhin sa jeni të rinj dhe të fortë e të shëndetshëm, dhe mos e lini për kur të plakeni!

Kush ka mundësi me e krye Haxhin, para se të plakët, ta kryejnë atë, nëse dëshiron ta shijojë!

Më kujtohet, që shpesh kemi mbajt ligjërata dhe këshilla para xhematit për ritualin e Haxhit, por mbasi kam shkuar atje dhe kur jam kthyer kam thënë me vete: A thua vallë ia kam shpjeguar si duhet njerëzve Haxhin?! Sepse, ndryshe është me fol për Haxhin dhe ndryshe është ta përjetosh kur shkon atje.

Nga qëndrimi im në Arafat, ajo që me bëri përshtypje, përtej organizimit perfekt dhe kushteve tepër të mira, ishte gjendja dhe fytyrat e njerëzve në atë vend; fytyra të bukura të përkushtuara, fytyra të ndritura, ndoshta efekti i qëndrimit në atë vend dhe i lutjeve e i adhurimit.

Më janë dukur njerëzit më të dashur, më të gatshëm dhe më afër njëri-tjetrit!

Së fundmi, do të shtoj diçka që më erdhi në mendje. Unë jam kthyer nga Haxhi pak para grupit tonë për arsye familjare dhe pune, dhe i takoi që u ktheva në ditën e enjte, dhe të nesërmen shkova për me mbajt hutben e xhumasë. Teksa po rrija në dhomën time të imamit, po shihja Qaben në televizion, dhe Subhanallah, sa larg mu duk dhe sa mall ndjeva në atë çast për të shkuar serish!

I lutem Allahut të na e mundësojë sërish Umren dhe mundësi për Haxh në të ardhmen, amin!

Gjatë këtij takimi të ngrohtë dhe të përzemërt, vazhduan edhe më tej kujtimet dhe përjetimet e haxhilerëve të tjerë, të cilët kujtonin me shumë mall pjesë dhe momente të ndryshme të paharruara nga Haxhi i tyre. Të gjithë, nuk e fshihnin dot, emocionin dhe mallin për të shkuar sërish në ato vende të shenjta dhe në atë tokë të bekuar, e cila çdo vit, madje tashmë në çdo ditë të vitit pret me miliona mysafirë dhe të ftuar nga Allahu i Madhëruar, duke iu përgjigjur thirrjes së Tij: Lebbejkeallahumme lebbejk! – T'u përgjigja Ty, o Zoti im, t'u përgjigja!”

Allahu ua pastë pranuar secilit Haxhin e tij dhe ia mundësoftë të shkojnë sërish atje!


(Shkodër, 28 qershor 2025
Aktivitet i zhvilluar nga Myftinia Shkodër,
në nder të haxhilerëve të këtij viti)



Besi Bekteshi
Gazetar, analist

Ajo që po ndodh sot në tregun e Zdrales në Shkodër nuk është thjesht një debat për tenda apo për hapësira tregtare. Është një refleksim i thellë i një mentaliteti që ka marrë formë në vitet e tranzicionit shqiptar: ideja se prona e tjetrit mund të jetë e jotja, për aq kohë sa ke qenë aty për shumë vite. Kjo sjellje që sot manifestohet si zemërim ndaj Komunitetit Musliman dhe Bashkisë së Shkodrës, nuk është gjë tjetër veçse një version i zbutur i një filozofie të vjetër grabitjeje kolektive.

Që nga rënia e komunizmit, Shqipëria është përballur me sfidën e rikthimit të pronës tek pronari legjitim. Por kjo sfidë është përplasur vazhdimisht me një lloj “moraliteti informal” që e ngre përdoruesin e paligjshëm në status të padiskutueshëm, thjesht sepse “ka qenë aty për vite”. Ky moral i rremë e sheh pronarin si pengesë, si padrejtësi, madje si armik të zhvillimit.



“ZEMËRIMI I ZDRALES – NOSTALGJIA E UZURPIMIT DHE POLITIKA E PRONËS SË TJETRIT”

Në këtë rast, pronari është Komuniteti Musliman i Shkodrës – një institucion fetar që kërkon të zhvillojë hapësirën e tij për qëllime të veta komunitare apo ekonomike. Dhe si përgjigje, tregtarët që për më shumë se 30 vjet kanë shfrytëzuar këtë pronë pa asnjë marrëveshje afatgjatë apo ndarje të drejtë, shpërthejnë në zemërim. Nuk është çudi që në zhargonin e protestës së tyre fillojnë të dëgjohen termat si “oligarkë”, “pazar politik”, “bashki që shitet”, e kështu me radhë – një fjalor i huazuar nga një opozitë që ka ndërtuar narrativën e saj mbi sulmin ndaj çdo iniciative që synon të vërë rregull.

A nuk është kjo një formë moderne e retorikës së vitit 1967? Atëherë, ishte regjimi komunist që i shpalli luftë fesë, pronës fetare, kishës, xhamisë. Sot nuk kemi më ideologji komuniste, por kemi nostalgjinë e uzurpimit: një nostalgji që ngjall të njëjtën zemërim ndaj institucioneve fetare kur ato kërkojnë të rikuperojnë pronën që iu është marrë në mënyrë të heshtur në demokraci mbas dhunës nën diktaturë. Ndryshon koha, por mentaliteti mbetet: “e imja është, sepse e kam përdorur”.

Ky konflikt nuk është një problem urbanizimi. Është një problem kulture politike dhe ligjshmërie. Në vend që të kërkojnë një zgjidhje të civilizuar për largimin dhe sistemimin në një vend tjetër, një pjesë e tregtarëve kanë

zgjedhur të luajnë kartën e viktimizimit dhe konfuzion. Ata nuk e shohin Komunitetin Musliman si institucion me të drejta pronësore, por si pengesë për biznesin e tyre personal – një mendësi që duhet sfiduar me forcën e ligjit dhe me dinjitetin e shoqërisë civile.

Ironia e gjithë kësaj është se, ndërkohë që akuzojnë për “oligarki”, janë vetë ata që për 30 vjet kanë përfituar nga një situatë pa pronar, pa taksa reale, pa përgjegjësi. Dhe kur kjo situatë merr fund, zëri i tyre bëhet më i fortë se zëri i ligjit.

Bashkia e Shkodrës për urbanitetin në Zdrale dhe Komuniteti Musliman për pronën janë në të drejtën e tyre për të zhvilluar territorin në përputhje me ligjin dhe planin urbanistik. Opozitarizmi që ngrihet mbi baza të tilla nuk është kauzë, por është keqkuptim i qëllimshëm – një përpjekje për të mbrojtur jo të drejtën, por status quo-në e padrejtësisë.

Në fund, kjo është një mundësi për qytetin dhe shoqërinë të tregojnë se vërtet janë pjesë e një demokracie funksionale: ku prona respektohet, institucionet gëzojnë autoritet, dhe populli nuk bie më pre e manipulimit emocional të atyre që e kanë ndërtuar pasurinë e tyre mbi tokën e tjetrit. Dhe më e rëndësishmja – që Shkodra nuk do të kthehet më kurrë në vitin 1967.



Redi Shehu
Analist

Gjithçka që dinim rreth dhunës, është përmbysur tashmë. Gjithçka që dinim rreth vrasjes është zhvlerësuar tashmë. Gjithçka që dinim rreth pastrimit etnik është tretur tashmë dhe gjithçka që dinim rreth vdekjes është vlarë tashmë. Në Gaza, po përmbysen konceptet tona. Ne, thjesht paskemi jetuar brenda një tullumbaceje vlerash e cila nuk i rezistoi gjembit të parë me të cilin u ndesh.

Iluzionit të të jetuarit brenda një hipnoze shoqërore të universalitetit të sakrificës, të ndërkombëtarizimit të konsensusit dhe të reagimit parandalues, duket se i ka ardhur fundi. Ndoshta është më mirë. Më mirë se sa të jetosh brenda një bote iluzive i papërgatitur për traumën që të pret, sepse më mirë të jesh në muzgun e një sistemi hipokratik, se sa në agimin e tij, sigurisht, më mirë se sa një rend i cili përpaket vazhdimisht të vrase kujtesën e të gjithëve ne.

Pyetja legjitime që të vjen menjëherë në mendje është se çfarë mund të ketë përtej asaj që ndodh në Gaza dhe në Palestinë? Ku janë kufijtë e njerëzimit? Cili është fundi me të cilin ne përkufizojmë veten tonë si qenie njerëzore? Përgjigjen e këtyre pyetjeve fatkeqësisht nuk e gjetëm dot në Gaza dhe do vazhdojmë të mos e gjejmë! Kjo që ndodh në Gaza, me orkestrimin e urisë si mjeti themelor i gjenocidit i cili drejton kah eliminimi, është një përsëritje e Auschwitz-it në kohët moderne, pa pasur nevojën e një komande naziste, por me institucione ndërkombëtare dhe me retorikë të luftës kundra terrorizmit.

Psikologu i famshëm hebre Gabor Mate, familja e të cilit qe zhdukur në Auschwitz, tregon se gjermanet përdornin urinë deri në ekstrem, pastaj për të realizuar spastrimet etnike, u ofronin të uriturve copa buke me reçel me kushtin e vetëm që të hipnin në

GJITHÇKA QË DINIM RRETH VRASJES, DHUNËS DHE PASTRIMIT ETNIK ËSHTË ZHVLERËSUAR TASHMË!

Ajo që habit të gjithë, është apatia e Perëndimit kolektiv ndaj sprovës më të madhe që ai ka hasur në raport me ngrehinën që vetë ndërtoi pas Luftës së Dytë Botërore. Ekziston një justifikim i heshtur që merr trajtat e një alibie ndaj gjenocidit.

trenat e vdekjes. Sot, përdorimi i urisë ndaj palestinezëve, duke i grumbulluar qëllimisht në pak zona shpërndarjeje me qëllim pastrimin e pjesës tjetër të territorit, është një kopje perverse e ndërtuar në një Auschwitz të hapur si Gaza, por me ndryshimin që në vend të reçelit, u jepen plumba.

Ajo që habit të gjithë, është apatia e Perëndimit kolektiv ndaj sprovës më të madhe që ai ka hasur në raport me ngrehinën që vetë ndërtoi pas Luftës së Dytë Botërore. Ekziston një justifikim i heshtur që merr trajtat e një alibie ndaj gjenocidit. Asgjë nuk u bë, dhe ja tani, kemi gjëndjen më të rëndë humanitare në historinë moderne të botës. Duket se refuzimi ndaj gjenocidit nuk kishte qenë kurrë një ndjenjë e vërtetë. Ka qenë pjesë e literaturës, gazetarisë dhe teksteve ligjore, por kurrë nuk paska qenë pjesë e softit të qytetërimit i cili më së shumti e prodhoi atë gjatë kolonizimeve dhe dy luftrave botërore.

Nga krahu tjetër, gjendja e popujve arabë dhe myslimanë duket sikur ka ngelur një kopje e pandryshuar e rezonancës koloniale e cila edhe pse fizikisht nuk është më aty, ka lënë pasojat e kolonizimit të mendjes, ndërgjegjes dhe moralit shoqëror të atyre vendeve. Pafuqia dhe pamjaftueshmëria nuk janë produkt vetëm i rrethanave sociale, më së shumti janë produkt i rrethanave mendore dhe besimore të cilat përthyhen në pranimin në heshtje të poshtërimit, fyerjes dhe degradimit.

Prandaj, ajo që ndodh në Palestinë tash e 76 vjet, dhe ajo që ndodh në Gaza, duket sikur është një fat i parashkruar në mendjet e myslimanëve, një destin gati gati i normalizuar, sepse mendja koloniale është mësuar me myslimanin që vuan, shkatërrohet digjet e vritet dhe asgjë e askush nuk mund të jetë përgjegjës.

Zhvillimet e kohëve të fundit nuk janë thjesht përpjekjet për të mbijetuar të një populli martir dhe guximtar si palestinezët, por janë përpjekjet e të

gjithë myslimanëve për t'u çliruar nga kurthi shekullor i mpirjes, amnezisë dhe përgjumjes koloniale.

Nëse Perëndimi kolektiv ka sot një përplasje të brendshme, e cila e dyzon mes qytetërimit liberal demokratik dhe mendësisë koloniale që i vërtitet sipër kokës si një fantazëm e së shkuarës, Lindja heterogjene myslimane përpaket të dalë nga makthi i mendjes së kolonizuar drejt vlerave humane të fesë në të cilën beson. Duket se rruga e të ftilluarit të dy krahëve të botës, po përcaktohet nga një grup i vogël njerëzish që i detyron të kalojnë doemos përmes humnerës së luftës dhe kimit.

Në mes të Perëndimit dhe Lindjes ndodhet një popull, i cili të gjithë këtë përplasje mundohet ta ushqejë përmes justifikimi me terrorizëm, i cili lehtësisht dekonstruktohet thjesht me lejimin e mediave ndërkombëtare që të hyjnë në Gaza. Është po ky popull që sipas sondazhit të organizuar nga akademiku izraelit Tamir Sorek, profesor i Universitetit të Pensilvanisë në bashkëpunim me kompaninë izraelite të sondazheve "Geocartography Knowledge Group", realizuan një matje në Mars të 2025 dhe të botuar në gazetën izraelite "Haretz", ku sipas të dhënave dilte se 82% e izraelitëve janë pro spastrimit etnik në Gaza dhe 47% e tyre dëshirojnë vrasjen e çdo burri, gruaje dhe fëmije atje.

Kaq mjafton që kjo matje shkencore të na japë një arsye më se logjike dhe të mjaftueshme që civilizim perëndimor dhe ai lindor të kuptojnë se aleanca mes tyre është e vetmja mënyrë për të ruajtur globin nga përçarja, dhuna dhe degradimi. Këtë, jo thjesht duke deklaruar se do njohim Palestinën (që në vetvete është një akt i drejtë dhe i moralshëm), por duke ndërprerë furnizimet si dhe duke vënë nën embargo Izraelin. Këto do ishin masa që realisht do tregonin se Perëndimi e ka seriozisht shqetësimin, dhe jo thjesht një maskë për të mbuluar mëkatet e së shkuarës.

MYFTIU PRITI IMAMË TË NDERUAR SHQIPTARË NË ZVICËR

Ditën e mërkurë, më 23 korrik 2025 Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror imamët e nderuar shqiptarë, H. Festim Miftari e H. Valon Iljazi, me aktivitet në Zvicër.

Gjatë takimit, Myftiu i Shkodrës, shprehu mirënjohjen e tij për kontributin e madh të imamëve shqiptarë në diasporë, si dhe përpjekjet e tyre për përhapjen e vlerave islame dhe ato kombëtare në mesin e popujve të tjerë.

Bashkërisht kujtuan momente të paharruara nga vizitat e Myftiut në Zvicër dhe bashkëpunimet me vlerë ndër vite.

Myftiu i njohu imamët e nderuar edhe me historikun e Islamit në Shkodër, kontributet e disa prej personaliteteve



islame të shquara ndër shekuj, si dhe i ftoi për të vizituar bashkërisht edhe xhaminë e Plumbit.

Me këtë rast, vëllezërit e shtrenjtë



patën mundësi të shihnin nga afër këtë vepër të shtrenjtë me peshë, që zbukuron Shkodrën dhe hartën e Islamit në mbarë trojet shqiptare.

Gjatë vizitës në xhaminë e Plumbit, imamët e nderuar u njohën me historikun e xhamisë së Plumbit, Zonës ku ajo gjendet, si dhe simbolikën e saj për myslimanët e Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë, me theks te ngjarja historike e 16 nëntorit 1990.

Për nder të vëllezërve të dashur, Myftiu i Shkodrës shtroi një drekë, gjatë së cilës u këmbyen biseda me vlerë dhe interes të përbashkët.

MYFTIU ZHVILLOI NJË TAKIM PUNE ME KRYETARIN E BASHKISË SHKODËR

Paraditën e së mërkurës, më 30 korrik 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bashkinë e Shkodrës, ku u prit nga Kryetari i saj, z. Benet Beci.

Gjatë takimit u diskutua për çështje me interes të përbashkët, si dhe për shqetësime të ndryshme që Myftinia Shkodër ka, sidomos me lirimin e ambienteve të ndryshme të vakëft, në qytet e fshat.

U soll në vëmendje edhe shqetësimi i tregtarëve të Tregut Zdralej, rreth të cilit bashkëbiseduesit ishin të një mendimi që prona duhet respektuar dhe se, është e drejtë e të zotit ta shfrytëzojë e zhvillojë atë sipas interesave të tij.

Myftiu e informoi Kryetarin e Bashkisë për qëndrimin e tij zyrtar në lidhje me këtë çështje, qëndrim i bërë publik gjatë hytbes së xhumasë, më 11 korrik 2025, në xhaminë e Parrucës.



Nga ana e tij, Myftiu i Shkodrës, ofroi disa alternativa, që Bashkia mund të shfrytëzojë për të gjetur një zgjidhje për qytetarët e prekur nga prishja e Tregut Zdralej, me qëllim që kjo lëvizje e vonuar, por që vjen në kohën e vet, të jetë me sa më pak dëme për qytetarët e prekur.

U diskutua edhe për tema të tjera me interes të përbashkët, si dhe u dakordësua për vazhdimin e bashkëpunimit në interes të qytetit dhe qytetarëve, si dhe ruajtjes së tabanit, frymës së harmonisë dhe respektit të ndërsjellët në mesin e institucioneve dhe përgjegjësjve që ato kanë.

AUSTRALIA OSE KOMONUELTHI I AUSTRALISË

Australia, zyrtarisht Komonuelthi i Australisë, është një vend që përfshin kontinentin australian, ishullin e Tasmanisë dhe ishuj të shumtë më të vegjël. Australia, në vetvete, është kontinenti më i vogël ndër kontinentet e globit tokësor dhe një nga vendet më të mëdha. Ajo gjendet në hemisferën jugore, mes Oqeanit Paqësor dhe atij Indian. Kontinenti Australian shtrihet afërsisht 4,000 km nga perëndimi në lindje dhe 3,200 km nga gadishulli Kejp Jork në verilindje në Uilsons Promontori në juglindje. Në jug, juridiksioni australian shtrihet edhe 500 km në skajin jugor të ishullit të Tasmanisë, dhe në veri shtrihet deri në brigjet jugore të Papua Guinesë së Re.

Australia ndahet nga Indonezia në veriperëndim, nga detet Timor dhe Arafura; në verilindje ndahet nga Papua Guinea e Re me anë të Detit të Koraleve dhe ngushticës së Torresit; nga Territori i Ishujve të Detit Koral ndahet nëpërmjet Barrierës së Madhe; në juglindje ndahet nga Zelanda e Re nëpërmjet detit Tasman; nga Antarktida, në jugun e largët, ndahet nëpërmjet Oqeanit Indian.

Vendi ka një sipërfaqe prej 7,688,287 km², dhe një popullsi prej 27,736,500 banorësh (viti 2025).

Kryeqyteti i Australisë është **Kanberra**, i vendosur në juglindje, midis qendrave më të mëdha dhe më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore të Sidneit dhe Melburnit.

GJEOGRAFIA

Australia përbëhet nga kontinenti australian, ishulli i Tasmanisë, ishuj të shumtë më të vegjël në det të hapur, territoret e largëta në det të ishujve Ashmore dhe Kartier, ishulli i Krishtlindjes, ishujt Kokos, ishujt e Detit Koral, ishujt Heard dhe McDonald dhe ishulli Norfolk. Australia gjithashtu pretendon rreth 42% të Antarktidës si Territori Australian Antarktik, por ky pretendim njihet vetëm nga katër vende të tjera.

Kontinenti australian është kontinenti më i vogël në botë, dhe si Australi, vendi është i gjashti në botë për nga sipërfaqja e përgjithshme. Australia ka 35,877 km vijë bregdetare, duke përfshirë të gjithë ishujt në det të hapur.

Shumica e Australisë është e thatë ose gjysmë e thatë. Në vitin 2021 Australia

kishte 10% të livadheve dhe kullotave të përhershme globale. Mbulesa pyjore përbën rreth 17% të sipërfaqes së tokës së vendit. Kontinenti australian është relativisht i sheshtë, me një lartësi mesatare prej 325 metrash mbi nivelin e detit, krahasuar me lartësinë 870 metra që e kanë kontinentet e tjera. Vargmali i madh ndarës “The Great Dividing Range”, shkon përgjatë pjesës më të madhe të Australisë lindore, duke ndarë ultësisrat qendrore nga malësitë lindore. Mali Koziosko është mali më i lartë në kontinent, me 2,228 metra mbi nivelin e detit. Më të larta janë malet Mouson Peak në ishullin Heard, me 2,745

ndikon negativisht në tokën e Australisë, e cila është relativisht e varfër në lëndë ushqyese në krahasim me standardet botërore.

KLIMA

Klima e Australisë varion nga tropikale e lagësht në verilindje dhe veriperëndim, në të thatë në qendër. Jugu bregdetar është i butë dhe i lagësht me ngrirje dimërore dhe borë në malësitë juglindore dhe në Tasmani. Klima ndikohet nga pozicioni i Australisë në “gjerësitë gjeografike të kuajve” që tenton të sjellë kushte të thata klimatike. Në përgjithësi, kontinenti Australian



m mbi nivelin e detit, dhe në Territorin Australian Antarktik, malet McKlintok dhe Menzies, përkatesisht në 3,492 m dhe 3,355 m mbi nivelin e detit.

Murrei-Darling është sistemi kryesor i lumenjve që përshkon pjesën më të madhe të Uellsit të Ri Jugor dhe Quinsland-it Jugor, dhe që derdhen drejt liqenit Aleksandrina dhe detit në Australinë Jugore. Ekzistojnë gjithashtu sisteme më të vogla të lumenjve bregdetarë, sisteme lumenjsh në brendësi, si sistemi Lake Ejre, gjithashtu edhe sisteme të liqeneve të kripura në Australinë qendrore dhe perëndimore. Lumenjtë e Australisë kanë derdhjen më të ulët në det nga çdo kontinent tjetër. Profili i sheshtë dhe gjithashtu i thatë i kontinentit, i bën lumenjtë e tij të lëvizin ngadalë, duke rezultuar në një akumulim kripe në tokë. Kripëzimi

është kontinenti më i thatë i banuar, me reshje mesatare vjetore prej 470 milimetrash. Rreth 70% e vendit është e thatë ose gjysmë e thatë, dhe rreth 18% e tij është shkretëtirë.

Klima ndikohet gjithashtu nga sisteme të ndryshme si lëkundjet El Niño-Jugore, Dipoli i Oqeanit Indian dhe Annular Mode Jugore. Australia ka ndryshueshmëri të pazakontë në reshje brenda viteve dhe midis viteve, duke çuar në thatësi të shpeshta dhe përmytje. Musoni i verës sjell reshje të konsiderueshme në Australinë veriore dhe qelizat me presion të ulët sjellin reshje dimërore në jug. Rajonet më të nxehta janë në veriperëndim të vendit dhe më të ftohtat në juglindje, kurse në Australinë jugore rënia e zjarreve është një gjë e zakonshme.

EKONOMIA

Australia është një ndër vendet më të zhvilluara ekonomikisht në botë, e dalluar për qëndrueshmërinë dhe fuqinë e saj tregtare. Me një ekonomi të hapur dhe të orientuar drejt eksportit, ajo ka arritur të ndërtojë një sistem të ekuilibruar mes burimeve natyrore, inovacionit dhe shërbimeve. Një nga shtyllat kryesore të ekonomisë australiane është sektori minerar. Pasuria e madhe në burime natyrore, si hekuri, qymyri, ari dhe gazi natyror, e ka bërë Australinë një nga eksportuesit më të mëdhenj në botë. Këto burime jo vetëm që gjenerojnë të ardhura të mëdha, por edhe mbështesin tregtinë e vendit me partnerët kryesorë, si Kina, Japonia dhe SHBA-ja.

Megjithatë, ekonomia australiane nuk mbështetet vetëm te burimet natyrore. Sektori i shërbimeve luan një rol të rëndësishëm, duke përfshirë financat, arsimin dhe turizmin. Arsimi i lartë ka tërhequr mijëra studentë nga e gjithë bota, ndërsa bukuritë natyrore të vendit – si Great Barrier Riif dhe Uluru – e bëjnë turizmin një burim të rëndësishëm të ardhurash.

Australia është një nga vendet me cilësinë më të lartë të jetesës. Sistemi i saj i mirëqenies sociale dhe pagat konkurruese u ofrojnë qytetarëve një standard të lartë ekonomik. Kjo, së bashku me një treg pune të fortë dhe politika të favorshme për bizneset, e bën Australinë një vend tërheqës për investitorët dhe emigrantët. Në tërësi, suksesi i ekonomisë australiane qëndron në aftësinë e saj për t'u përshtatur dhe për të diversifikuar burimet e të ardhurave. Me një balancë mes shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe inovacionit në sektorët e shërbimeve, Australia vazhdon të mbetet një nga ekonomitë më të forta dhe më të qëndrueshme në botë.

HISTORI

Banimi njerëzor i kontinentit australian vlerësohet të ketë filluar 50,000 deri në 65,000 vjet më parë, me migrimin e njerëzve nga urat tokësore dhe kalimet e shkurtra në det nga ajo që tani është Azia Juglindore. Strehimi shkëmbor i Maxhedbebe në Arnhem Land, është ndoshta vendi më i vjetër që tregon praninë e njerëzve në Australi. Mbetjet më të vjetra njerëzore të gjetura janë mbetjet e Liqenit Mungo, të cilat datojnë rreth 42,000 vjet më parë.

Kultura australiane aborigjene është një nga kulturat më të vjetra të vazhdueshme në tokë. Në kohën e kontaktit të parë evropian, Australianët Aborigjenë i përkisnin një game të gjerë



KRYEQYTETI, KANBERRA

shoqërisht, me ekonomi të ndryshme të përhapura në të paktën 250 grupe të ndryshme gjuhësore. Vlerësimet numrit të popullsisë aborigjene përpara vendosjes britanike atje, variojnë nga 300,000 në 3 milionë. Kulturat australiane aborigjene ishin dhe mbeten thellësisht të lidhura me tokën dhe mjedisin, me historitë e “The Dreaming”, të ruajtura përmes traditës gojore, këngëve, vallëzimit dhe pikturave. Grupe të caktuara nga ata u angazhuan në bujqësi dhe në gjuajtjen e peshkut, dhe ndërtuan strehimore gjysmë të përhershme.

Njerëzit e ishujve të ngushticës Torres u vendosën për herë të parë në ishujt e tyre të paktën 2500 vjet më parë. Të dallueshëm kulturalisht dhe gjuhësisht nga popujt aborigjenë të kontinentit, ata ishin detarë dhe e siguronin jetesën e tyre nga hortikultura sezonale dhe burimet e shkëmbinjve nënujorë dhe deteve të tyre. Në vitet 1300 u shfaq edhe bujqësia në disa ishuj dhe fshatra. Nga mesi i shekullit të 18-të në Australinë veriore u krijuan kontaktet, tregtia dhe angazhimi ndërkulturore midis grupeve vendase aborigjene dhe ‘trepangerëve makasan’, që vinin dhe vizitonin vendin nga Indonezia e sotme.

Anija e kompanisë Hollandeze të Indisë Lindore – Duijken - me kapiten Uillem Xhanszūn, bëri zbarkimin e parë të dokumentuar evropian në Australi, në vitin 1606. Udhëtimi i Abel Tasman në vitin 1642 ishte ekspedita e parë e njohur evropiane që arriti në tokën e Van Diemen, dhe në udhëtimin e tij të dytë të vitit 1644, ai hartoi bregun verior të Australisë, në jug të Guinesë së Re. Pas udhëtimeve të Tasmanit, holandezët ishin në gjendje të bënin harta pothuajse të plota të brigjeve veriore dhe perëndimore të Australisë, dhe gjithashtu edhe të shumë brigjeve jugore dhe juglindore të Tasmanisë. Ata e quajtën kontinentin “New Holland” (Hollanda e Re).

Në vitin 1770, kapiteni Xhejms Kuk lundroi përgjatë bregut lindor dhe bëri hartën e këtij bregu, të cilin ai e quajti “New South Wales” (Uellsit të Ri Jugor), dhe pretendoi të ishte i Britanisë së Madhe. Në vitin 1786, qeveria britanike njoftoi synimin e saj për të krijuar një koloni penale në Uellsin e Ri Jugor. Më 26 janar të vitit 1788, flota e parë britanike e komanduar nga kapiteni Artur Filip, mbërriti në Sidni Cove, në Portin Xhekson. Atje u krijua një kamp dhe u ngrit flamuri i Unionit. Kjo datë më vonë u bë Dita Kombëtare e Australisë.

150 vjet pas vendosjes evropiane në Australi, popullsia indigjene ra në numër, kryesisht për shkak të sëmundjeve infektive. Autoritetet koloniale britanike nuk nënshkruan asnjë traktat me grupet aborigjene. Ndërsa vendbanimi u zgjerua, dhjetëra mijëra njerëz indigjenë dhe mijëra kolonë u vranë në konfliktet kufitare, për të cilat shumë historianë argumentojnë se përfshinin akte gjenocidi nga kolonizatorët. Këta të fundit ua shpronësuan popujve indigjenë të mbijetuar pjesën më të madhe të tokës së tyre.

Në vitin 1827 pretendimi britanik u shtri në të gjithë kontinentin australian. Kolonia e lumit Swan (Perti i sotëm) u krijua në vitin 1829, duke u evoluar në koloninë më të madhe australiane sipas sipërfaqes. Koloni të veçanta u formuan nga Uellsit i Ri Jugor: Tasmania në vitin 1825, Australia e Jugut në vitin 1836, Viktoria në vitin 1851 dhe Queensland në vitin 1859. Australia e Jugut dhe Viktoria u themeluan si koloni të lira.

Mes viteve 1855 – 1890, gjashtë koloni fituan individualisht qeveri të përgjegjshme, duke menaxhuar shumicën e punëve të tyre, brenda Perandorisë Britanike. Zyra Koloniale në Londër mbajti kontrollin e disa çështjeve, veçanërisht të punëve të jashtme. Që nga viti 1856, parlamentet koloniale



**XHAMIA SHQIPTARE (AAIS),
MELBOURNE**

zgjeruan në mënyrë progresive të drejtat e votimit për burrat e rritur, dhe më vonë, mes viteve 1890 – 1900 iu dha e drejta e votës edhe grave.

Në mesin e shekullit të 19-të, eksplorues të tillë si Burke dhe Uills, hartuan brendësinë e Australisë. Zbulimi atje i zonave të arit, në fillim të viteve 1850, çoi në një fluks migrantësh të rinj nga Kina, Amerika e Veriut dhe Evropa kontinentale, po ashtu edhe në shpërthime të trazirave civile.

Pas një dekade planifikimi, konventash kushtetuese dhe referendumesh, më 1 janar të vitit 1901, në Australi u krijua federata e kolonive, e cila rezultoi në krijimin e “Komonuelthit të Australisë”, si një komb nën kushtetutën e re australiane. Nga kjo datë tashmë, Australia ishte një territor sovran vetëqeverisës, brenda Perandorisë Britanike. Statuti i Uestminster-it i vitit 1931, i dha fund autoritetit të Mbretërisë së Bashkuar për të nxjerrë ligje për Australinë në nivel federal pa pëlqimin e Australisë.

Në vitin 1914, Australia iu bashkua aleatëve në Luftën e Parë Botërore dhe mori pjesë në luftime në disa fronte. Nga 324,000 burra që shërbyen jashtë shtetit, rreth 60,000 u vranë dhe 152,000 të tjerë u plagosën. Shumë australianë e konsiderojnë humbjen e Korpusit të Ushtrisë Australiane dhe Zelandës së Re (ANZAC) në Galipoli të Turqisë, në vitin 1915 si “pagëzimi i zjarrit” që farkëtoi identitetin e kombit të ri. Fillimi i fushatës përkujtohet çdo vit në Ditën e Anzakut - një datë që rivalizon Ditën e Australisë - si më e rëndësishmja e kombit.

Nga viti 1939 deri në 1945, Australia iu bashkua aleatëve në Luftën e Dytë Botërore. Forcat e armatosura të Australisë luftuan në luftërat e Paqësorisht,

Evropës dhe Mesdheut dhe të Lindjes së Mesme. Tronditja e disfatës së Britanisë në Singapor në vitin 1942, e ndjekur menjëherë pas bombardimit të qytetit të Darvinit dhe sulmeve të tjera japoneze në tokën australiane, çoi në një besim të përhapur në Australi se një pushtim japonez ishte i pashmangshëm. Kjo rezultoi në një zhvendosje të aleancës: nga aleanca me Mbretërinë e Bashkuar, në aleancën me Shtetet e Bashkuara si aleati kryesor dhe partneri i sigurisë së Australisë. Që nga viti 1951, Australia ka qenë aleate me Shtetet e Bashkuara sipas traktatit ANZUS.

Në tri dekadat pas Luftës së Dytë Botërore, Australia përjetoi rritje të konsiderueshme në standardet e jetesës dhe zhvillimin periferik. Qeveritë inkurajuan një valë të madhe emigrimi nga e gjithë Evropa dhe i quajtën këta emigrantë “australianë të rinj”. Emigrimi i lartë u justifikua te australianët duke përdorur sloganin “populloju ose zhduk”, dhe nga vitet 1960 politika e ‘Australisë së Bardhë’ u lehtësua gradualisht.

Pas heqjes së gjurmëve të fundit të politikës së ‘Australisë së Bardhë’ në vitin 1973, demografia dhe kultura e Australisë u transformuan si rezultat i një vale të madhe dhe të vazhdueshme emigrimi joevropian, kryesisht nga Azia. Fundi i shekullit të 20-të pa gjithashtu një fokus në rritje në lidhjet e politikës së jashtme me vendet e tjera të Azi-Paqësorisht.

Aktet e Australisë të vitit 1986 ndërprejnë lidhjet e mbetura kushtetuese midis Australisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke ruajtur monarkun në cilësinë e saj të pavarur si Mbretëresha e Australisë. Në një referendum kushtetues të vitit 1999, 55% e votuesve e kundërshtuan shfuqizimin e monarkisë dhe kthimin në një republikë.

GJUHA

Australia nuk ka një gjuhë zyrtare, megjithatë, anglishtja është gjuha kombëtare që flitet pothuajse në mënyrë universale atje. Në Australi ka qindra gjuhë aborigjene (vendase indigjene autoktone), megjithëse shumë prej tyre janë zhdukur që nga viti 1950, dhe shumica e gjuhëve të mbijetuara kanë shumë pak folës. Mabuiag, e folur në ishujt perëndimorë të Ngushticës Torres, dhe gjuha e shkretëtirës perëndimore kanë rreth 8,000 dhe 4,000 folës, përkatësisht, dhe rreth 50,000 njerëz aborigjenë mund të kenë ende njohuri të ndonjë gjuhe australiane.

Në Australi fliten gjithashtu edhe gjuhët e grupeve të emigrantëve që jetojnë atje. Përveç anglishtes, pesë gjuhët kryesore që fliten në Australi, janë: Mandarin (kineze), Arabisht, Kantonezisht, Vietnamisht dhe Italisht.

FEJA

Shumica e australianëve deklarohen si të krishterë, me 43.9% të popullsisë. Islami në Australi përbën 3.2% të popullsisë, dhe pjesa tjetër deklarohen si hindu, budistë, hebrej, etj.

Përqindjet e regjistruara si të krishterë ortodoksë, myslimanë dhe budistë u rritën ndjeshëm në fund të shekullit të 20-të. Nga ana tjetër, pothuajse tri të dhjetat e australianëve nuk pretendonin asnjë fe.

Ndryshe nga kolonët evropianë, komunitetet tradicionale aborigjene janë jashtëzakonisht shpirtërore. Atje feja i jep kuptim jetës dhe tema koordinuese është lidhja e qëndrueshme midis tokës dhe njerëzve.

SI ERDHI ISLAMI NË AUSTRALI

Është një fakt i dëshmuar se Islami në Australi u prezantua nga peshkatarët indonezianë të njohur si makassar-ë, të cilët e vizitonin Australinë prej shumë shekujsh, përgjatë bregut verior të Australisë. Ata vinin nga ishujt lindorë të Indonezisë, veçanërisht nga rajoni Makassar. Kjo ka ndodhur shumë përpara vendosjes britanike në Australi në vitin 1788.

Ky kontakt i grupeve etnike të Azisë Juglindore të besimit islam me Australinë mund të identifikohet nga varret që ata gërmuan për shokët e tyre që vdiqën në udhëtim, varre të cilat i bënë të kthyer nga Meka, në përputhje me rregullat islame të varrosjes së të vdekurve. Varret e njerëzve të Makassar-it janë të përhapur në të gjithë zonën bregdetare veriore të Australisë. Po ashtu, ky kontakt me ta dëshmohet edhe nga

pikturat e shpellave dhe ceremonitë fetare aborigjene që përshkruajnë dhe përfshijnë adoptimin e modeleve dhe fjalëve të kanoeve Makassar. Historitë e Makassar-it kujtohen ende në historitë e aborigjenëve dhe festohen në ceremonitë e tyre të shenjta.

Pas ardhjes së evropianëve, me ndihmën e ushtrisë britaniko-indiane kolonialistë britanikë sollën në Australi muslimanë nga Afganistani, të cilët përdorën devetë e tyre për të transportuar mallra dhe njerëz nëpër shkretëtirën e “palundrueshme”. Këta afganë muslimanë që do të merrnin pjesë në zbulimin e Australisë qendrore dhe gjithashtu do të punësoheshin në ndërtimin e rrugëve, transportit dhe linjave telegrafike midis qyteteve të largëta të Australisë. Emigrantët myslimanë arritën ta mbillnin me vendosmëri Islamin në tokën australiane.

Këta afganë muslimanë, sa i përket arsimimit, shumica ishin analfabetë, por ishin myslimanë të devotshëm dhe çfarëdo që dinin ata e praktikonin. Ata ndërtuan një sërë xhamish të thjeshta në vendet ku punonin, nga Port Augusta në Australinë e jugut dhe deri në Alice Springs në veri.

Një nga xhamitë më të vjetra në Australi që u ndërtua nga afganët në fund të shekullit të kaluar ishte xhamia e Maresë, e ndërtuar në vendin e quajtur Ura Murraj në Australinë e jugut. Në vitin 1976, kjo xhami u shpall pjesë e Trashëgimisë Kombëtare Australiane. E ndërtuar në stacionin Vangamanna, xhamia Marree konsiderohet xhamia e parë e ndërtuar në Australi. Ajo nuk është vetëm një pikë referimi historike, por edhe një përfaqësim simbolik i zhvillimit të mbështetur nga emigrantët myslimanë dhe se si komuniteti mysliman dhe njerëzit e vendit ndihmuan në ndërtimin e qytetit Marree, në Australinë jugore.

Grupi i tretë i madh i emigrantëve myslimanë filloi të vendosej në Australi gjatë viteve 1950, kur qeveria australiane ndryshoi politikën e saj të imigracionit. Në fund të shekullit të 20-të, Australia u bë një strehë për shumë muslimanë që iknin nga konfliktet, duke përfshirë ato në Liban, Bosnjë, Irak, Iran, Sudan dhe Afganistan. Emigrimi i përgjithshëm, i kombinuar me konvertimin fetar në Islam nga të krishterët dhe nga australianë të tjerë, si dhe pjesëmarrja e Australisë në përpjekjet e OKB-së për refugjatët, e ka rritur popullsinë e përgjithshme myslimane në vend. Rreth 36% e muslimanëve janë të lindur në Australi. Myslimanët e lindur jashtë vijnë nga një

larmi e madhe kombesh dhe grupesh etnike – me komunitete të mëdha libaneze dhe turke.

Myslimanët sot janë të vendosur në të gjithë Australinë, veçanërisht në juglindje të Australisë, dhe banojnë kryesisht në New South Wales dhe Viktoria. Popullsia aktuale myslimane në Australi është 3.2% e popullsisë së përgjithshme të vendit, ose ndryshe afërsisht 887,568 shtetas, nga 27,736,500 banorë që ka Australia në total (vlerësim i vitit 2025).

Në Australi ka më shumë se 288 xhami, musal’la dhe qendra, dhe gjithashtu 38 shkolla fillore dhe të mesme islame. Numri i institucioneve myslimane dhe islame është gjithmonë në rritje. Të gjitha këto arritje janë bërë gjatë rreth njëzet viteve të fundit.

1,140 njerëz u identifikuan si muslimanë aborigjenë në regjistrimin e vitit 2011, pothuajse dyfishi i numrit të tyre në regjistrimin e vitit 2001.

Nga myslimanët australianë të shquar përmendim boksierin Antoni Mundine; punonjës in komunitetit dhe yllin e ligës së regbit, Hazim El-Masri; lojtarin e kriketit Osman Khavaxha dhe akademikun Valid Ali.

Në vitin 2013, deputeti laburist Ed Husic u bë anëtar i parë mysliman i Kabinetit të Australisë, duke shërbyer shkurtimisht si Sekretar Parlamentar pranë Kryeministrit dhe për Broadband në qeverinë e dytë Rudd.

Xhamia e parë dhe më e vjetra e ndërtuar në Viktoria të Australisë, është ajo e ndërtuar në Shepparton, nga shqiptarët - xhamia e Sheppartonit - në fund të viteve 1950. Xhamia është në pronësi dhe qendra e Shoqatës Myslimane Shqiptare Shepparton (SAMS).

Xhami tjetër e vjetër e ndërtuar nga shqiptarët në Australi, është ajo e njohur si “Xhamia e Shoqërisë Islame Shqiptare Australiane”, ose “Xhamia e Karlton-it”. Ajo ndodhet në Karlton North, një periferi e brendshme e Melburnit, po në Viktoria të Australisë. Ndërtimi i saj filloi në mesin e viteve 1960 dhe përfundoi në vitin 1969. Xhamia është nga më të vjetrat në Melburn dhe është e listuar në Regjistrin e Trashëgimisë Viktoriane.

Përgatiti:

Msc. Arta ujkaj, teologe

<https://en.wikipedia.org>
<https://grandmufti.com.au>
<https://www.britannica.com>
<https://albanian-australian-islamic-society.wheree.com>
<https://sheppartonalbaniansociety.org>



PROF. DR. MURHAF SAKKA
(PEDAGOG NË MAJMAAH UNIVERSITY, A.SAUDITE)



Ajeti i parë që zbriti ishte fjala e Allahut të Madhëruar: “Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi!” - (Kur’ani, El-Alak: 1)

Dhe ajeti i fundit që zbriti është fjala e Allahut të Madhëruar: **“Dhe frikësohuni ditës kur do të ktheheni tek Allahu, pastaj çdo njeriu do t’i jepet ajo që ka fituar dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi!”** - (Kur’ani El-Bekare: 281)

Fillimi i Islamit nisi me urdhrin për dijen, duke kërkuar ndihmë prej Allahut, dhe përfundimi i dijes, që të çon drejt adhurimit të sinqertë dhe arritjes së devotshmërisë ndaj Tij.

Ndërmjet 'Lexo' dhe 'Frikësohuni' qëndrojnë ajetet e dispozitave, ajetet që flasin për krijimin e njeriut dhe të gjithësisë, për besimin dhe akiden, dhe sqarimit të përfundimit të të gjitha krijesave dhe fateve të tyre.

Si vërtetim i fjalës së Allahut të Madhëruar: **“Ne nuk kemi lënë asgjë pa e shënuar në Libër; pastaj te Zoti i tyre ata do të mbledhen!”** - (Kur’ani, El-En’am: 38)

Kështu që, kush mëson dhe nuk ka frikë, ka humb, është mashtruar dhe i ka rënë në gjunjë shejtanit.

Dhe, kush e kërkon devotshmërinë pa dije, gjithashtu ka humbur, ka shpikur dhe ka tejkaluar!





Evans Drishti

Jemi në verë, dhe njëra nga frazat kyçe që hasen në përditshmëri është “fluks emigrantësh”

Emigrantë të ikur që në eksodin e 90’tës, e që tashmë kthehen të rritur, të maturuar, e mbi të gjitha familjarë.

Tashmë ata zënë pozicionin e prindërve të moshës së tretë, pasi janë rritur fëmijët e tyre të lindur dhe të rritur në emigracion.

Në një shtëpi të madhe, diku në një lagje të hershme të qytetit, oborri gjallon. Fëmijë të vegjël, por edhe adoloshentë, fëmijë të rritur tashmë. Më i madhi nga fëmijët 28 vjeçar, e më i vogli vetëm 3 vjeçar. Familja ka 4 fëmijë dhe të gjithë kanë emigruar prej vitesh. Njëri në Angli, tjetri në Itali, njëra në Spanjë e tjetri në Amerikën e largët. Tashmë të katër fëmijët janë bërë familjarë, janë bërë prindër dhe fëmijët e tyre ua kanë kaluar edhe vetë prindërve për nga gjatësia.

Por, ajo që të bën përshtypje është se shqipja tek këta fëmijë emigrantësh është shumë e varfër, e ndërkohë dëgjon të flitet rrjedhshëm anglishtja, italishtja e spanishtja.

Një krenari e madhe e prindërve, teksa dëgjojnë fëmijët e tyre të flasin në gjuhë të huaja, por asnjëri prej tyre nuk flet shqip, kanë mësuar vetëm pak fjalë përshëndetëse dhe me aq janë mjaftuar. Aspak më shumë!

Gjyshërit e tyre përpqen të kënaqen me nipër e mbesa vetëm me gjuhën e shpirtit. Janë të detyruar të mjaftohen me kaq. Ata s’i kuptojnë se ç’flasin me njëri – tjetrin. Mjaftohen vetëm me përqafime, me përkëdhelje, me ledhatime, me puthje në faqe... Ata duan të flasin me ta, por s’arrijnë dot, pasi shqipja për ta është tepër e largët. Ata duan t’u rrëfenjë historitë e rrugëtimeve të tyre jetësore, duan t’u tregojnë si u rritën prindërit e

KUJDES!...

PO SHKOJMË DREJT NJË ASIMILIMI TË FRIKSHËM DHE TË VETËDIJSHËM NJËHERAZI

tyre, por e kanë të pamundur...

Hyn në një market të qytetit. Diku dëgjohej të flitet anglisht e pak më tutje gjermanisht e italisht. Të duket vetja sikur je në një vend të Europës, e jo në vendin tënd. Ngushëllohesh me faktin se “janë emigrantë”, por a s’janë shqiptarë? Prindërit e tyre nuk morën as më të voglin mundim t’ua mësonin shqipen fëmijëve të tyre, jo thjesht dhe vetëm “disa fjalë”, por një shqipe të meritueshme.

Diku në një media dëgjon një intervistë me një figurë të rëndësishme dhe publike të vendit tonë. E dëgjon me kujdes, e teksa vjen momenti të flitet për familjen, personazhi i ftuar shprehet se dy fëmijët e vet i kanë emigruar prej vitesh, tashmë të mirëshkolluar në botën Perëndimore, të martuar tashmë andej dhe prej kohësh kanë ndërtuar edhe familjet e tyre.

Gazetari pyet:

-U martuan me shqiptarë apo...?

Përgjigja:

-Jo! Me të huaj. Kështu erdhi kjo jetë! Të dy kanë marrë të huaj dhe janë bërë prindër.

Gazetari pyet sërish:

-Nipërit dhe mbesat a flasin shqip?

Përgjigja:

-Jo! Vetëm disa fjalë! Megjithëse e ëma dhe i ati përpqen disi, por jetojnë andej dhe flasin gjuhën e vendit të tyre.

Të tilla raste janë të shumta në vendin tonë.

E kuptueshme që kjo gjeneratë do rritej e do shkollohej në vende të ndryshme të Europës e më gjerë, pasi qëllimi i një emigracioni ishte dhe mbetet “largimi nga vendi yt” “për një jetë më të mirë”

Por, mbetet gjithnjë detyrim prindëror që fëmijët të mësojnë gjuhën amë të prindërve, ashtu sikurse duhet të mësojnë patjetër edhe kulturën e vendlindjes prindërore

Së pari: mos të harrojmë se një fëmijë që vjen në jetë nga dy prindër të kombësive të ndryshme arrin të mësojë dhe të kuptojë deri në pesë gjuhë të ndryshme. Ndaj njohja dhe mësimi i

gjuhës mëmë është gjenetike, jo thjesht “dëshirë”.

Së dyti: Fëmija është trashëgimtar i identitetit prindëror dhe për rrjedhojë “degë e pemës gjenealogjike të trungut familjar”, ndaj prindi e ka për detyrë ta informojë fëmijën e vet dhe ta njohë më nga afër me trashëgiminë e familjes së vet, të prindërve, të rrethit familjar: halla, daja, axha, teze, e më gjerë. Mos harrojmë se ka shumë fëmijë emigrantësh që për fat të keq nuk njohin as rrethin familjar më të afërt, dhe për këtë nuk janë fajtorë ata si fëmijë, por prindërit e tyre që nuk realizuan si duhet detyrat e tyre prindërore.

Së treti: Kthimi në vendlindje s’duhet të ngelet thjesht “një kënaqësi” e momentit duke shkuar e kaluar kohën nëpër kafenet apo restorantet e qytetit, por është “detyrim prindëror, që fëmijëve të vegjël apo të rritur në moshë, t’u ofrohen informacione të bollshme rreth kulturës familjare dhe shoqërore, ku u rritën dhe u edukuan prindërit e tyre.



GJYSHËRIT E TYRE PËRPQEN TË KËNAQEN ME NIPËR E MBESA VETËM ME GJUHËN E SHPIRTIT. JANË TË DETYRUAR TË MJAFTOHEN ME KAQ. ATA S’I KUPTOJNË SE Ç’FLASIN ME NJËRI – TJETRIN. MJAFTOHEN VETËM ME PËRQAFIME, ME PËRKËDHELJE, ME LEDHATIME, ME PUTHJE NË FAQE..!

Kështu:

- Sa prindër emigrantë ka që i shëtisin fëmijët e tyre nëpër lagjet dhe rrugicat e fshatit apo qytetit për të parë nga afër banesat dhe dyert e hershme?

- Sa prindër emigrantë ka që i dërgojnë fëmijët e tyre në muze për t’u njohur me historikun e vendlindjes prindërore?

- Sa prindër emigrantë ka që ua prezantojnë fëmijëve të tyre mësuesen e klasës së parë, miqtë e ngushtë të familjes së tyre, komshinjtë e lagjes, foto të larmishme të fëmijërisë së kaluar,

që lozin së bashku me fëmijët lojrat e tyre fëmijërore, që vizitojnë shkollën ku ata morën dijen dhe kulturën e parë, shoqërinë e tyre të fëmijërisë, vendet e bukura ku kaluan momente të këndshme të fëmijërisë dhe rinisë së tyre, pikat më të veçanta të hapësirave ku jetuan, kalanë e qytetit, kinemanë, teatrin, bibliotekën, qendrën e kulturës, galerinë e arteve...?

- Sa prindër amigrantë ka që ua bëjnë të ditur fëmijëve të tyre të rritur dhe arsimuar në botën e jashtme se si dhe sa funksionojnë gjërat këndeje për të bërë një krahasim me zhvillimin e tyre më botën e jashtme; në mënyrë që të jenë më të vetëdijshtë për vlerat që trashëgojnë prindërit e tyre;

psh:

- të shohin nga afër si është një stacion treni apo autobusi

- si është një ambient shkolle

- sa janë hapësirat e gjelbërta këndeje dhe sa të disponueshme janë për të realizuar qoftë edhe një piknik,

- sa e frekuentueshme është një bibliotekë apo një librari,

- sa të interesuar janë njerëzit këndeje me botanikën, me gjallesat nënujore apo mbitorësore,

- sa funksionalë janë semaforët e qytetit, si dhe sa zbatohen rregullat e qarkullimit rrugor,

- sa të zhvilluara janë parqet për lodra apo këndet argëtuese,

- si funksionojnë parkingjet

- si procedohet me hedhjen e mbeturinave,

- sa vizitohen monumentet e kulturës si: një urë e vjetër, kulla e orës, ndërtesa të vjetra...

- si funksionon një treg frutash e perimesh, në ç’kushte tregtohen, në ç’çmime ofrohen,

- si funksionon një traditë familjare shqiptare,

- cila është gjeneza e familjes trashëgimtar i së cilës është...

Ky brez i ri që po rritet dhe zhvillohet në botën e jashtme janë shtylla kurrizore e identitetit tonë shqiptar, me të cilët duhet të krenohemi për çdo arritje të tyre.

Ndaj, s’janë vendet e huaja që po ndikojnë “për keq” në zhvillimin tonë, por janë gjeneratat prindërore që po shkojnë “të vetëdijshtë” drejt një “asimilimi” të frikshëm që po çon jo vetëm në humbjen graduale të gjuhës, por edhe në tjetërsimin e kulturës mëmë.

PSE NUK DUHET TË HESHTIM PËR LUFTËN E SHKODRËS 1912-1913?

Pse nuk duhet të heshtim për Luftën e Shkodrës 1912-1913?

Sepse ajo është lufta më e madhe që kanë berë shqiptarët gjatë gjithë shek.XX-të.



HASAN BELLO

Përceptimi i përgjithshëm i mbrojtësve të Shkodrës ishte se, një nga shkaqet e epërsisë së forcave malazeze ishte ndihma ushtarake që ajo mernte nga Serbia. E plot keqardhje, edhe ajo e malësorëve shqiptarë që luftonin kundër forcave të mbrojtjes. “Po thonë që serbi i ka çue nja 20 000 vetë asqerë Malit t’Zi për ndihmë. Asqerët që kanë ik thoshin se “na batisi malcija që vjen e na këcen

ndër istikame, se për malazezët nuk kena zor”.

Pavarësisht rrethanave ekstreme dhe kequshqyerjes, në radhët e mbrojtësve nuk mungonte humanizmi. “Kur i kanë çue me hangër nishanxhi-taborit, ata nuk e kishin mbajtë bukën tue i thanë: “Danje nëpër fukara se nuk asht koha me hangër bukë”.

Kjo deklaratë rrëqethëse, vinte kur armiku kishte 72 orë që bombardonte qytetin dhe popullsinë civile pa pushim.



ATMOSFERË EDUKATIVE DHE ARGËTUESE E KURSEVE VERORE NË QENDRËN KULTURORE BARBULLUSH

Para disa ditëve kanë nisur kurset verore intensive në Qendrën Kulturore, pranë xhamisë Barbullush me pjesëmarrjen e rreth 70 nxënësve (djem dhe vajza) të moshave të ndryshme.

Në vargun e veprimtarive që zhvillohen në këtë Qendër me fëmijët e kurseve, përveç mësim-edukimit islam është edhe argëtimi dhe zbavitja me veprimtari e lojëra të ndryshme, aktrime, shfaqje në monitor të filmave vizatimore edukativ, etj, ku shfrytëzohen mundësitë për të kaluar orë të gëzueshme dhe të dobishme.

Në këto kurse verore, që organizohen nga Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit, pasditen e të mërkurës, më 2 korrik 2025, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, zhvilloi një vizitë pune, për të parë nga afër zhvillimin e plan-programit të këtyre kurseve verore, i cili gjatë takimeve dhe bisedave me grupet e nxënësve, falënderoi mësuesin H. Ervis Molla si dhe përgjegjësen dhe mësuesen



e qendrës, znj. Suada Tahiri, për punën dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, gjatë gjithë procesit mësimor të kurseve, si dhe prindërit, të cilët dërgojnë fëmijët e tyre në këto programe me karakter edukativ dhe zbavitës.

Në fund, teologu Halluni dha edhe disa këshilla të dobishme për fëmijët, që do jenë pjesë e këtij aktiviteti për disa javë, deri në fund të korrikut në Qendrën

Kulturore Barbullush.

Qëllimi i këtyre kurseve intensive në këtë periudhë vere në shumë qendra dhe xhami të Shkodrës është forcimi i njohurive fetare të fëmijëve në një atmosferë të gjerë edukative dhe argëtuese, zhvillimi i vlerave të shëndosha islame dhe të paqes sociale, si dhe forcimi i lidhjes së tyre me xhaminë dhe komunitetin.

PËRMBYLLET ME EMOCIONE DHE FESTIME EDICIONI I 4-ËT I KURSIT VEROR “BUZ’QESH”

Në Xhaminë “Ebu Bekër”, për gjatë 3 javëve u zhvillua kursi veror intensiv “Buz’qesh” 2025, edicioni i 4-ët, me pjesëmarrjen e rreth 90 fëmijëve të moshave të ndryshme.

Ashtu si vitin e kaluar, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit, arriti që edhe këtë vit të gërshetojë me sukses edukimin islam me argëtimin.

Qëllimi kryesor i këtij kursi veror intensiv, krahas argëtimit të fëmijëve ishte kombinimi i përsosur mes mësimi dhe argëtimit, duke siguruar një eksperiencë të paharrueshme për ta.



Si përherë, gjatë këtyre tre javëve nuk munguan veprimtaritë krijuese vetjake dhe të ndara në katër grupe, si dhe lojërat zbavitëse të shumëllojshme, si dhe ekskursione, që u zhvilluan në ditën e fundit të tij, në Kompleksin “Zmijani”.

Në ceremoninë e mbylljes, më 4 korrik 2025, teologu Arben Halluni, drejtues i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër ka falënderuar fillimisht pjesëmarrjen e rregullt të fëmijëve, prindërit e tyre dhe në mënyrë të veçantë bashkëpunimin e teologes, znj. Zamira Bushati, psikologen

znj. Almeda Tusha dhe asistentet vullnetare, të cilat ndihmuan në realizimin e këtij aktiviteti të dobishëm arsimor, edukativ dhe argëtues.

Për këtë bashkëpunim të vyer të tyre Myftinia Shkodër u dha nga një certifikatë vlerësimi dhe mirënjohjeje, ndërsa fëmijëve pjesëmarrës nga një dhuratë simbolike.

Në fund të kësaj ceremonie pati urime dhe përqaftime të përzemërta midis mësuesve dhe fëmijëve.



VIZITË FRYMËZUESE E NXËNËSVE TË KURSEVE VERORE TË XHAMISË DRAGOÇ NË XHAMINË E PARRUCËS

Paraditën e të shtunës, më 5 korrik 2025, nxënësit e kurseve verore intensive të organizuara në xhaminë dhe Qendrën Kulturore të Dragoçit në kuadër të plan-programit arsimor dhe edukativ zhvilluan një vizitë edukuese dhe shpirtërore në xhaminë e Parrucës.

Nxënësit u pritën ngrohtësisht nga drejtuesi i sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili u mbajti një bisedë këshilluese dhe motivuese për jetën dhe suksesin.

Në fjalën e tij, ai theksoi rëndësinë e vendosmërisë dhe qëndrueshmërisë në rrugëtimin drejt një qëllimi të lartë.

“Një nga faktorët më të rëndësishëm për të arritur suksesin në jetë është qëndrueshmëria për qëllimin që ia kemi



vënë vetes,” u shpreh teologu Halluni.

Më pas, takimi u vijoi me pyetje-përgjigje, si dhe disa nga nxënësit shfaqen përgatitjen e tyre në lëndët e mësim-besimit, të Kur’anit, etj.

Nxënësit, të ndarë në grupe moshash të ndryshme, u shoqëruan në këtë vizitë nga mësuesi dhe imami i xhamisë Dragoç, H. Shkëlqim Sykaj, i cili përkujdeset për edukimin fetar të tyre gjatë gjithë kursit veror.

KURSET VERORE INTENSIVE SHTRIHEN EDHE NË XHAMITË GUR I ZI DHE ZUES



Sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër po vazhdon me përkushtim organizimin e projektit të kurseve verore intensive në disa xhami të qytetit dhe fshatrave. Këto ditë, kurset janë zgjeruar edhe në xhamitë e Gurit të Zi dhe të Zuesit, ku dhjetëra fëmijë e të moshave të ndryshme marrin pjesë në to.

Përveç mësimi të bazave të besimit islam, si leximi dhe shkrimi i Kur’anit Famëlartë, fjalët dhe parimet e besimit, në këto kurse zhvillohen edhe



aktivitete të ndryshme edukative, argëtuese dhe zbavitëse, që synojnë forcimin e tyre moralisht, shpirtërisht dhe fizikisht.

Këto kurse janë vizituar së fundmi edhe nga drejtuesi i sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili u takua me nxënësit dhe mësuesit e xhamive Gur i Zi dhe Zues, H. Ridvan Fregaj dhe znj. Kimete Elezi, ku zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë, duke dhënë këshilla të dobishme për përkushtimin ndaj dijes dhe sjelljen e mirë në familje dhe në shoqëri.

PROGRAMI I KURSIT VEROR INTENSIV ZGJEROHET EDHE NË XHAMINË E VUKATANËS



Në fillim të këtij muaji kanë nisur kurset verore intensive në xhaminë Vukatanë me pjesëmarrjen e rreth 50 nxënësve (djem dhe vajza) të moshave të ndryshme.

Në vargun e veprimtarive që zhvillohen në këtë xhami me fëmijët e kurseve, përveç mësim-edukimit islam është edhe argëtimi dhe zbavitja me veprimtari e lojëra të ndryshme, etj, ku shfrytëzohen mundësitë për të kaluar orë të gëzueshme dhe të dobishme.

Në këto kurse verore, që organizohen nga Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit, para ditën e së mërkurës, më 9 korrik 2025, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, zhvilloi një takim dhe vizitë për të parë nga afër zhvillimin e këtyre kurseve

verore, i cili gjatë takimeve dhe bisedave me grupet e nxënësve, falënderoi hoxhën Vullnet Pishtari si dhe mësuesen znj. Avidan Gucija për punën dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, gjatë gjithë procesit mësimor të kurseve, si dhe prindërit, të cilët dërgojnë fëmijët e tyre në këto programe me karakter edukativ dhe zbavitës.

Në fund, teologu Halluni dha edhe disa këshilla të dobishme për fëmijët, që janë pjesë e këtij aktiviteti për disa javë në xhaminë Vukatanë, si dhe pyeti nxënësit për përgatitjen e tyre mësimore, duke i inkurajuar të vazhdojnë me përkushtim dhe vullnet në rrugën e dijes.

MYFTINIA SHKODËR, KONTRIBUT FAMILJES REXHEPI NË GOLEM PAS DJEGIES SË SHTËPISË

Më 10 korrik 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari bëri një vizitë familjes Rexhepi në fshatin Golem, Njësia Administrative Rrethina për t'i shprehur ngushëllimet dhe solidarizim kësaj familje të nderuar me rastin e fatkeqësisë së djegies së shtëpisë, e cila u përfshi nga flakët, por fatmirësisht pa viktima në njerëz.

Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga Administratori i Njesisë Administrative Rrethina, z. Gerald Hasaj panë nga afër dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesë e qytetarit Nimet R. Rexhepi dhe i shprehën ngushëllimet dhe solidarizimin e tyre me fatkeqësinë e ndodhur, që shkaktoi djegien e shtëpisë, por vetëm dëme materiale.

Me këtë rast, Myftiu Sytari i dorëzoi një shumë të mbledhur në xhamitë e Shkodrës, të cilat për dy xhuma rresht, u bënë thirrje besimtarëve të solidarizohen me familjen Rexhepi, si kontribut solidarizimi i tyre me këtë familje në fatkeqësinë e saj.

Në bisedën e zhvilluar me kryefamiljarin, z. Nimet Rexhepi, Myftiu theksoi rëndësinë e durimit dhe mbështetjes të Zotit i Madhëruar, të cilat janë vendimtare në përballimin dhe tejkalimin e sprovave dhe fatkeqësive, që na ndodhin në jetën e kësaj bote. Ai,



u lut me zemër, që ta kalojnë këtë sprovë dhe të kenë besim dhe mbështetje tek Allahu i Madhëruar, se Ai është Ndhmësi dhe Mbështetësi më i madh. Myftiu Sytari falënderoi edhe krejt besimtarët e Shkodrës, të cilët iu përgjigjën thirrjes për ndihmë dhe u lut, që Zoti i Madhëruar t'i ndihmojë dhe t'u bëhet mbështetje në kapërcimin e kësaj fatkeqësie.

Z. Nimet R. Rexhepi, falënderoi Myftininë Shkodër dhe të gjithë ata, të cilët kanë kontribuar dhe u janë gjetur pranë në këto momente të vështira.

Myftinia Shkodër u bën thirrje gjithë qytetarëve të Shkodrës, institucioneve, bizneseve, deputetëve dhe krejt bamirësve që të vazhdojnë të kontribuojnë për këtë familje në përballimin e fatkeqësisë së tyre dhe njëkohësisht lutemi, që Zoti i Madhëruar t'u japë ndihmën dhe mbarësinë e tij në mbështetje të këtyre familjarëve, për t'u kthyer sa më parë në shtëpitë e tyre.

Lista e kontribuesve:

Emri	Shuma	
	Lekë	Valutë
Xhamia "Ebu Bekër"	50.800	
Xhamia Parrucë	140.000	100 €
Xhamia Dragin	150.000	
Xhamia e "Dy Vajzave"	84.500	50 €
Xhamia e Medresesë	61.000	305 € 20 €
Xhamia Dërgut	49.800	20 € 5 €
Xhamia Perash	30.000	
Xhamia Obiliq	28.000	
Xhamia Rus	23.700	
Xhamia Kallaj	20.900	25 €
Xhamia Bahçallik	19.600	
Xhamia Dudas	14.800	615 €
Xhamia Gur i Zi	14.000	40 €
Xhamia Mëlgush	13.000	20 €
Xhamia Luarz	6.500	35 €
Xhamia Mes-Myseim	4.000	
Fatjon Bushati		2.000 €
Serdar Kraja		50 €
Ilirjan Kallaj	5.000	
Total:	715.600 lekë	3.260 € 25 €

Në fund, Imam Muhamed B. Sytari dorëzoi shumën e mbledhur prej:

715.600 lekë (shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind lekë)

3.260 euro (tremijë e dyqind e gjashtëdhjetë euro)

25 paund (njëzet e pesë sterlina angleze)

Kjo shumë iu dorëzua familjes së shtetasit Nimet Ramë Rexhepi, më 10 korrik 2025.

EDUKIMI VEROR PËRFSHIN EDHE NXËNËSIT E XHAMIVE KUÇ E KOSMAÇ



Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit, po vazhdon me ritme të larta organizimin e kurseve verore intensive në xhamitë e qytetit dhe fshatrave. Këto ditë, nismës edukativo-fetare-argëtuese i janë shtuar edhe xhamitë Kuç dhe Kosmaç, duke përfshirë dhjetëra fëmijë të moshave të ndryshme në një atmosferë dinamike dhe plot gjallëri.

Programi i kurseve përfshin mësimin e bazave të fesë islame, leximin dhe



shkrimin e Kur'anit Famëlartë, si dhe njohjen me besimet, adhurimet dhe moralin islam.

Krahas aspektit fetar, kurset pasurohen me aktivitete të larmishme edukative dhe zbavitëse, të cilat ndikojnë pozitivisht në formimin moral, shpirtëror dhe shoqëror të fëmijëve.

Ditët e fundit, pikërisht më 15 dhe 16 korrik 2025 këto xhami janë vizituar nga teologu Arben Halluni, drejtues i arsimit në Myftininë Shkodër, i cili u



takua me fëmijët dhe mësuesit përkatës, H. Taksim Plori dhe H. Sami Plori. Në këtë vizitë, ai ndau me pjesëmarrësit disa këshilla të vlefshme mbi rëndësinë e diturisë, edukatës së mirë dhe sjelljes së denjë në m të gjithë njerëzit në përgjithësi.

Ky program me kurse intensive verore synon të jetë jo vetëm një mbështetje për edukimin fetar të brezit të ri, por edhe një hapësirë e dobishme në aspektin komunitar dhe zbavitës.

IMAMI SHKODRAN NË VJENË: "BESIMTARI DALLOHET PREJ MORALIT TË BUKUR TË TIJ!"



Me ftesë të Myftinisë Shkodër, ditën e xhuma, më 18 korrik 2025, hytben e xhumasë në xhaminë e Perashit e mbajti, H. Daut Kurtabegu, imam në Qendrën Islame Shqiptare "El-Buhari" në Vjenë.

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, zotëria e tij u ndal tek cilësitë dhe karakteri me të cilat besimtari dallohet në jetën e përditshme, sidomos në sprova dhe në vështirësi të ndryshe, me të cilat përballet gjatë jetës së tij, duke sjell shembuj nga jeta e profetit Jusuf (a.s), ku ndër të tjera theksoi: "Nëse dëshiron të jesh musliman i mirë, atëherë mos u mjafto vetëm me leximin e Kur'anit, por zhytu në thellësitë e urtësive të tij."

Poashtu, u ndal edhe tek porosinë e Pejgamberit tonë (a.s), ku tërhoqi

vëmendjen e besimtarëve, se sprovat e ndryshme që e godasin besimtarin, janë pastrim për të, duke cituar hadithin e të Dërguarit të Allahut (a.s) i cili thotë: "Çdo gjë që e godet besimtarin, prej lodhjes, sëmundjes, shqetësimit, pikëllimit, dëmtimit apo hidhërimit, bile edhe një gjemb që e shpon, vetëm se Allahu ia fal përmes tyre gjynahet e tij."

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet e saj për imamin e nderuar, H. Daut Kurtabegu, si dhe mesazhet e urta, me të cilat ai pati mirësinë t'i drejtohet besimtarëve.

Ftesat e imamëve, hatibëve dhe ligjëruesve të ndryshëm, sidomos gjatë sezonit veror, vijnë në kuadër të projekteve për gjallërimin e jetës fetare në qytetin e Shkodrës.

IMAMI SHKODRAN NË VJENË MBAN HYTBE NË XHAMINË E PARRUCËS



Me ftesë të Myftinisë Shkodër, ditën e xhuma, më 25 korrik 2025, në xhaminë e Parrucës mbajti hytben H. Ylli Buraniq, Imam i Islamisches Kultur- und Bildungszentrum "EN-NUUR" (Das Licht) – Vjenë.

Gjatë hytbes së xhumasë, imami i nderuar u ndal te rëndësia e tregimeve kur'anore dhe profetike, përmes të cilave duhet të nxjerrim mësim dhe të reflektojmë në jetën tonë të përditshme.

Imami i nderuar solli shembuj konkret nga Kur'ani Famëlartë, ku Allahu i Madhëruar na tërheq vëmendjen për mënyrën e të jetuarit tonë në këtë dynja dhe se nuk duhet të harrojmë, se Ai na ka krijuar, na ka furnizuar me të mirat e kësaj bote dhe se tek Ai do të kthehemi.

Ndër tjera Hoxhë Buraniqi theksoi se, njeriu nuk duhet të mashtrohet në këtë botë dhe të shkojë pas epsheve, por të shkojë në udhëzimin e Zotit të Madhëruar dhe të jetojë sipas urdhrave të Tij, në mënyrë që të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e Tij me xhenet.

Gjithashtu, ai u ndal edhe te mënyra e fitimit të pasurisë dhe shpenzimit të saj, ku njeriu duhet që në asnjë mënyrë të hutohet apo të mashtrohet gjatë kërkimit të rizkut, por të ruhet dhe ta fitojë atë hallall dhe ta shpenzojë në hallall.

NXËNËSIT E MEJTEPIT TË XHAMISË BARDHAJ NË NJË EKSKURSION EDUKATIV DHE KULTUROR NË VLORË



Nxënësit e kursit fetar të xhamisë Bardhaj, niveli i të rriturve, nën kujdesin e imamit dhe mësuesit H. Ilir Dizdari zhvilluan përgjatë dy ditëve, 16 dhe 17 korrik 2025 një ekskursion edukativo-kulturor në qytetin bregdetar të Vlorës.

Përpara nisjes, drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër në një përshëndetje i uroi për një udhëtim dhe ekskursion të bukur e të mbushur me përjetime të paharruara. Ai këshilloi që të marrin e japin nga kjo përvojë e re, përmes argëtimit, shijimit të natyrës, historisë dhe miqësisë e vëllazërisë me njëri-tjetrin.

Gjatë rrugës së tyre, ata patën mundësinë të ndaleshin në disa xhami të rëndësishme, si xhaminë "Riza Bajrami", në Durrës, xhaminë e Plumbit në Vlorë, etj, ku u njohën nga afër me historinë dhe funksionin e tyre në jetën e komunitetit besimtar.

Përveç ndalesave në objekte të trashëgimisë kulturore dhe monumente me rëndësi historike, nxënësit shijuan bukuritë natyrore që ofron deti Jon.

Ky aktivitet, në kuadër të shumë aktiviteteve verore të sektorit të arsimit pranë Myftinisë, i kombinuar ndërmjet edukimit fetar, kulturor, argëtimit dhe relaksimit, shërbejnë si një përvojë e vyer për të forcuar ndjenjën e identitetit fetar, trashëgimisë, historisë dhe vlerave të vëllazërisë.





KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISE
MYFTINIA SHKODËR

GAZA

TOKA QË NUK MPOSHTET KURRË!

**DINJITETI I MUNGUAR
I RACËS NJERËZORE!**

**Ky shkoj
njerzillëky?!**



MYFTINIASHKODER1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org